



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË PUKË**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN
FINANCIAR
TË USHTRUAR NË BASHKINË PUKË**

TIRANË, TETOR 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	2-6
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionimi i auditimit	
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	8-9
2.	Identifikimi i çështjes	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve	
5.	Kriteret e vlerësimit	
6.	Standardet e auditimit	
7.	Metodat e auditimit	
8.	Dokumentimi i auditimit	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	9-9
2	-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit	10-16
2.2	Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.	16-41
2.3	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	41-61
IV	REKOMANDIME	62-68

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit. Bashkia Pukë përbëhet nga 5 njësi administrative: njësia administrative Pukë (qyteti), njësi administrative Gjegjan, Rrapë, Qelëz dhe Qerret. Misioni i Bashkisë Pukë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve.

Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor. Pyjet natyrore, bimët mjekësore, pasuri nëntokësore minerare, janë karakteristikë e zonës së Bashkisë Pukë. Buxheti i Bashkisë Pukë financohet nga të ardhurat e veta të miratuar sipas paketës fiskale, nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuara, nga transfertat specifike, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij. Bashkitë janë institucione të rëndësishme të vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë, të cilat sigurojnë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi për Kontrollin e Lartë të Shtetit në kuadër të plotësimit të detyrimit të zbatimit të programit vjetor të auditimeve.

Gjithashtu auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2, në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”.

c. Qëllimi i auditimit. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Auditimi është kryer mbi baze risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem etj.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Janë formuluar 9 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 2 gjetje dhe rekomandime për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet, efektivitet dhe të ardhura të munguara.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

a-Përshkrimi i gjetjeve kryesore:

Gjetje nga auditimi: -Bashkia Pukë funksionon mbi bazën e rregullores së brendshme e cila është hartuar qysh në vitin 2015, pra 10 vite më parë, në një periudhë kur struktura organizative dhe detyrat funksionale të stafit kanë qenë të ndryshme nga ato të tanishmet. Për pasojë, ajo nuk pasqyron në mënyrë të plotë kërkesat, përgjegjësitë dhe funksionet aktuale të institucionit, çka krijon nevojën për rishikim dhe përditësim të saj. Kjo mangësi sjell paqartësi në organizim dhe përgjegjësi, mungesë të rregullave për koordinim dhe komunikim ndërmjet strukturave, dobësim të disiplinës dhe kontrollit të brendshëm, etj. Bashkia Pukë nuk ka hartuar kod të etikës për punonjësit, duke mos garantuar njohjen e detyrimeve etike që kanë punonjësit.

-Nga Bashkia Pukë është hartuar regjistri i riskut vetëm nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, por jo nga strukturat e tjera, si Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor, Sektori Juridik dhe prokurimeve Publike, Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë, Sektori i Burimeve Njerzore, etj, duke mos evidentuar si duhet nga kjo bashki rrisqet që rrezikojnë realizimin e objektivave në

tërësinë e institucionit, por pjesërisht, si dhe mos parashikimi prej tyre të masave për minimizimin e këtyre rrisqeve. -Gjithashtu edhe gjurma e auditimit është hartuar vetëm nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit por jo nga drejtorit dhe sektorët e tjerë të bashkisë.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal (dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion), nga ana e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës, fillojnë punë rishtas, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit.

Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e auditit të brendshëm në nivel sektori, por kjo strukturë nuk është plotësuar me asnjë punonjës, duke sjell mungesën e këshillave dhe sigurisë së arsyeshme për titulluarin e njësisë publike, për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo mangësi është në kundërshtim me strukturën e miratuar, si dhe ligjin nr.114-date-22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit rezulton se nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJM. Në regjistrin e aktiveve, për një pjesë të tyre vlerat janë regjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare, problematikë e mbartur që nga viti 2015 me bashkimin e ish komunave.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, konstatohet se janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka regjistër kontabël dhe informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, etj. Nuk ka informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit, për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet. Në territorin administrativ të bashkisë Pukë, janë miratuar lista përfundimtare e pronave vetëm për bashkinë dhe ish-komunën Qelëz. Për tre ish-komunat, Gjegjan, Rrape dhe Qerret nuk janë kryer procedurat e nevojshme nga Bashkia Pukë, me qëllim vijimin e procesit për miratimin e VKM-ve për transferimin e listës përfundimtare të pasurive të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Pukë, duke pamundësuar procesin e regjistrimit të këtyre pronave në ASHK.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” gjendja e kësaj llogarisë si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 ka vlerën 0 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me gjendjet e llogarisë kundërpanti 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitur në aktiv të bilancit në vlerën 51,376,834 lekë në fund të vitit 2023 dhe 48,503,919 lekë në mbyllje të vitit 2024. Pra në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, nuk pasqyron detyrimin prej 48,503,919 lekë që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme

Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme të institucionit nga të tretët, konstatohet se taksapaguesit privat dhe familjar, në fund të vitit 2024 kanë një detyrim të pa paguar ndaj Bashkisë Pukë për taksat dhe tarifat vendore, në vlerën 25,423,454 lekë, (vlerë debitore e pa arkëtuar). Gjendja e debitorëve progresiv për taksat dhe tarifat vendore në vlerën 25,423,454 lekë në fund të vitit 2024, si dhe krijimi i debitorëve të rinj gjatë këtij viti në vlerën 2,515,940 lekë , tregojnë për mos marrjen e masave të plota shtrënguese në rend shterues për arkëtimin e debitorëve nga Bashkia Pukë.

b. Përshkrimi i rekomandimeve kryesore.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së re për organizimin dhe funksionimin e institucionit, duke përcaktuar detyrat, kompetencat, linjat e bashkëveprimit etj., të çdo strukture të njësisë vendore. Gjithashtu të hartohet kodi i etikës për punonjësit e institucionit.

Nga të gjitha strukturat e Bashkisë Pukë në nivel drejtorie dhe sektori, të merren masa për hartimin e rregjistrimit të rriskut, si dhe të gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave të shkruara, lidhur me detyrimet që kanë punonjësit të cilët fillojnë punë rishtas, ndërpresin marrëdhëniet e punës, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit, për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal, (dorëzimin e dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe nëpunësi zbatues, të marrin masa për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit fizik të aktiveve afatgjata me qëllim marrjen e masave të mëtejshme për vlerësimin e tyre real dhe paraqitjen e vlerave të sakta në kontabilitet.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Zhvillimit Urban dhe Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Pukë të marrë masa si vijon:

-Të evidentojnë dhe të kontabilizojnë në mënyrë të plotë vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie, si dhe pronat e tjera troje sipas dokumentacionit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu gjendjen reale të aseteve në pronësi të bashkisë; -Të përfshijnë në regjistrat kontabël pasuritë e llojit pyje dhe kullota që me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave (VKM), i janë kaluar në pronësi njësisë vendore (ish-komunave), tashmë pjesë e bashkisë; -Të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, etj., për të siguruar verifikimin e titujve të pronësisë për të përfituar informacion të saktë mbi sipërfaqet dhe vlerat përkatëse.

Rekomandim: Drejtorja e Menaxhimit Financiar në bashkinë Pukë gjatë hartimit të pasqyrave financiare vjetore, të paraqesë në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin”, detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari të rakordojë me llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa për sigurimin e shërbimit të auditit të brendshëm, duke plotësuar me punonjës sektorin e auditit të brendshëm, në përputhje me strukturën e miratuar, ose sigurimin e këtij shërbimi nga njësi e auditimit të brendshëm të një njësie tjetër publike.

Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore në rend shterues, për arkëtimin e vlerës progresive prej 25,423,454 lekë, nga subjektet private dhe familjar, si detyrim i tyre ndaj njësisë vendore për taksat dhe tarifatat vendore.

A. OPINIONI I AUDITIMIT.

Opinionimi mbi pasqyrat financiare të vitit 2024.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Pukë për vitin ushtrimor 2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, etj., si dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare. që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion të kualifikuar¹ (me rezervë) për llogaritë vjetore të Bashkisë Pukë, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2024, të shprehura në bazën për opinion.

Baza për dhënien e opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, etj.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të përlllogaritur 7,930 mijë lekë, si dhe anomalitë e konstatuara, si vijon:

- Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, etj. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit, për të vërtetuar vlerën e tyre në kontabilitet.

- Nga auditimi i procedurës së inventarizimit rezulton se nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJ, ndërsa në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë regjistruar jo në vitin e krijimit, por në vitet kur ka filluar kontabilizimi.

- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, e cila ka vlerën 0 lekë, nuk rakordon me gjendjet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila ka vlerën 48,503,919 lekë, duke mos pasqyruar këtë detyrim që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara.

- Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, e cila përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të pa likuiduara, në mbyllje të vitit 2024 ka vlerën 9,341,031 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie janë konstatuar 92 raste, të cilat i përkasin periudhës kohore para muajit nëntor-dhjetor 2024, në vlerë 8,205,842 lekë. Kjo vlerë nuk është detyrim afatshkurtër e për pasojë duhej të paraqitej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku paraqiten detyrimet e prapambetura. Për pasojë llogaria 467 rezulton të jetë nënvlerësuar në shumën 8,205,842 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pukë.

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe

¹ SNA-705-Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Pukë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II.HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 619/1, datë 30.05.2025, i ndryshuar të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 05.06.2025 deri më datë 14.07.2025, në subjektin Bashkia Pukë u krye Auditimi Financiar, i cili mbuloi periudhën prej 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

B. M. (Përgjegjës Grupi).

R. L, auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit: Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Identifikimi i çështjes: Sipas veprimtarisë së subjektit, janë vlerësuar fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimet e auditimit, të miratuara në programin e auditimit, si më poshtë:

Mbi vlerësimin e funksionimit të MFK dhe auditit të brendshëm;

Procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;

Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

Përgjegjësitë e audituesve:

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.

Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”;

VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. i ndryshuar;

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.

Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

Udhëzimi i MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të vetëqeverisjes vendore”;

Rregullore e procedurave të auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Pukë, etj

Manual Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Manuali i Auditimit Financiar i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve i Kontrollit të Lartë të Shtetit, etj.

Standardet e auditimit të aplikuar: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit IFAC;

Metodat e auditimit: Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Auditim është kryer me zgjedhje, bazuar në rrishtun e vlerësuar.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (rrisku në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga testet e kontroleve, ose procedurat thelbësore të cilat përfshijnë testet e detajeve dhe procedurat analitike. Metodat kryesore të auditimit që u përdorën: ri performanca, kërkimi i të dhënave nëpërmjet pyetësorëve, intervistimet, llogaritjet (kontrollet aritmetike të shumave), inspektimi (ekzaminimi i dokumentacionit financiar, fatura, regjistrime dhe dokumente etj.), konfirmim nga të tretët, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

Dokumentimi i auditimit: Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar dokumentet standarde deri në këtë fazë të auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Bashkia Pukë përbëhet nga 5 njësi administrative: njësia administrative Pukë (qyteti), njësi administrative Gjegjan, Rrapë, Qelëz dhe Qerret. Misioni i Bashkisë Pukë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve.

Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor. Pyjet natyrore, bimët mjekësore, pasuri nëntokësore minerare, janë karakteristikë e zonës së Bashkisë Pukë.

Buxheti i Bashkisë Pukë financohet nga të ardhurat e veta të miratuar sipas paketës fiskale, nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuara, nga transfertat specifike, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

2. Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Rregullore e brendshme për funksionimin e administratës së Bashkisë Pukë.

Kodi i etikës.

Struktura e bashkisë.

Deklarata për cilësinë e kontrollit të brendshëm

Urdhri për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik.

Dokumente të tjera të përshkruara përgjatë materialit.

Informacioni elektronik i përgatitur nga Bashkia Pukë, në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga grupi i auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se bashkia Pukë ka marrë masa për hartimin dhe implementimin e 5 elementëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, por evidentohen edhe disa mangësi në këtë poçes, të trajtuara në vijim:

1-Mjedisi i kontrollit

Bashkia Pukë në përmbushje të politikave dhe objektivave ka hartuar plane dhe dokumente afatgjatë, të cilat synojnë arritjen e qëllimeve të saj.

- Plani strategjik i zhvillimit të Bashkisë Pukë (i pa azhornuar)

- Plani i integritetit 2022-2025

- Plani social 2021-2023, shtyrë deri në vitin 2025 me VKM për arsye të vonesave në hartimin e planit të ri social.

Bashkia Pukë funksionon mbi bazën e rregullores së brendshme e cila është miratuar me urdhrin nr.217 datë 30.12.2015, pra 10 vite më parë, duke mos patur përputhje të përmbajtjes së saj me strukturën aktuale, për shkak se gjatë kësaj periudhe janë bërë ndryshime thelbësore në organizimin e strukturës së njësisë vendore, ku janë shkrire struktura të vjetra dhe janë krijuar të reja, si dhe kanë ndryshuar detyrat dhe përgjegjësitë, si për shkak të strukturave të reja, edhe për shkak të ndryshimeve ligjore që janë bërë gjatë kësaj periudhe. Rregullorja e brendshme është

thelbësore për organizimin, kontrollin, funksionimin dhe llogaridhënien në çdo institucion publik. Mos hartimi i rregullores së re sjell mungesë qartësie në organizim dhe përgjegjësi, punonjësit nuk e dinë saktë çfarë detyrash, të drejtash dhe përgjegjësish kanë, krijohen mbivendosje apo shmangie të detyrimeve, mungojnë rregullat për koordinim dhe komunikim ndërmjet strukturave, ka problem në respektimin e standardeve ligjore dhe administrative, dobësohet disiplina dhe kontrollit i brendshëm, pasi pa rregulla të shkruara, është më e vështirë të vlerësohet performanca dhe të ndëshkohen shkeljet, ulet besimi i qytetarëve te institucioni, krijohet një klimë ku abuzimet janë më të lehta, etj. Mos hartimi i rregullores së re është me ndikim në organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së njësisë vendore, si dhe në mos përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8,9 dhe 20.

Drejtoria e Menaxhimit financiar ka ndarje te detyrave sipas pozicioneve te punës në organikë referuar shkresës nr.2182 date 27.11.2024

Bashkia Pukë nuk ka hartuar kod të etikës për punonjësit, duke mos garantuar njohjen e detyrimeve etike që kanë punonjësit, si dhe zbatimin e etikës personale dhe profesionale prej tyre.

Kodi i etikës në një institucion publik shërben për të përcaktuar rregullat e sjelljes dhe parimet etike që duhet të ndjekin punonjësit, si: ndershmëria dhe integriteti në punë, transparenca dhe shmangia e konfliktit të interesit, respektimi i ligjit dhe qytetarëve, përgjegjshmëria dhe profesionalizmi, etj. Qëllimi kryesor është të forcojë besimin e publikut, të mbrojë integritetin e institucionit dhe të udhëheqë sjelljen e punonjësve në situata të ndryshme pune. Pa një kod etike, të gjitha këto parime dhe rregulla nuk janë të sigurta se njihen dhe zbatohen si duhet.

Bashkia Pukë nuk ka rregullore të brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat, duke mos dhënë sigurinë e duhur për arkivimin, ruajtjen e administrimit dhe dokumenteve dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 42 (Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare).

Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk është hartuar program trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.

Sipas përcaktimeve në nenin 64, pika h “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë” të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për marrjen e masave për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive. Nevojat për trajnime janë plotësuar pjesërisht nga ndjekja e trajnimeve të organizuar nga ASPA.

Në urdhrat e nxjerra nga titullari në rastet e ndërprerjes së punonjësve nga puna, përcaktohet se punonjësi ka 5 ditë afat për dorëzimin e detyrës dhe të aktiveve (bazës materiale), por nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal (dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion), nga ana e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës, fillojnë punë rishtas, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit (lëvizje paralele, ulje, apo rritje në detyrë). Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për ruajtjen e informacionit elektronik nga ana e punonjësve, gjë e cila ka të bëjë edhe me dorëzimin e këtij informacioni të eprori, apo punonjësi tjetër kur bëhen ndërprerja e marrëdhënieve të punës, apo lëvizjet brenda institucionit.

Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët përkatës të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri dhe janë në kundërshtim me:

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13.

-VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, pika 50.

-Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 “Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit”.

Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Nga Bashkia Pukë është hartuar regjistri i riskut vetëm nga Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Ndihmës Ekonomike, por jo nga strukturat e tjera, si Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor, Sektori Juridik dhe prokurimeve Publike, Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë, Sektori i Burimeve Njerzore, etj, duke mos evidentuar si duhet nga kjo bashki rrisqet që rrezikojnë realizimin e objektivave në tërësinë e institucionit, por pjesërisht, si dhe mos parashikimi prej tyre të masave për minimizimin e këtyre rrisqeve. Këto mungesa janë më ndikim në veprimtarinë e njësisë vendore dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 21.

Për anëtarët e GMS nuk janë kryer trajnime lidhur me njohjen e MFK si dhe Manualit të MFK në interes të rritjes së njohjeve për menaxhimin e riskut, si dhe të elementëve të tjerë të MFK.

Aktivitetet e Kontrollit

Veprimtaritë e kontrollit kanë të bëjnë kryesisht me miratimin e procedurave dhe politikave të shkruara para faktit dhe pas faktit, për të dhënë siguri të arsyeshme, që rrisqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Është ngritur grupi menaxhimit strategjik me urdhrin nr.14 datë 13.03.2024, janë bere takime me drejtuesit e ekipeve, ku janë evidentuar problematikat ne buxhetim dhe planifikim.

Është miratuar sistemi i dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë.

Nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se nga titullari janë miratuar rregullat për garantimin e ruajtjes së informacionit dhe të aktiveve të njësisë.

Për fushën e IT nuk ka sistem rezerve back-up, duke mos garantuar ruajtjen e informacioneve nga cenimi apo humbja e të dhënave si pasojë e mungesës së procedurave të rikuperimit në raste fatkeqësie, etj.

Mangësitë lidhur me aktivitetet e kontrollit janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 22.

Informacioni dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësisve publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre.

Menaxhimit (titullarit, drejtorëve, pra sipas shkallës hierarkike) duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë, në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe

efektivitet. Se cilat janë këto lloj raporte dhe sa herë gjatë vitit duhet të përgatiten, duhet të jenë shkruar dhe miratuar në dokumente të brendshme të institucionit.

Të gjithë punonjësit duhet të njihen me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem (cilat raporte ka për detyrë të hartojë për eprori, dhe cili është afati i hartimit të këtij raporti). Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë. Prandaj, titullari dhe punonjësit janë pjesë e rrjetit të komunikimit. Titullari duhet të marrë informacione të sakta, të vërteta, të përshtatshme dhe në kohën e duhur mbi të gjithë aktivitetin e njësisë. Transmetimi i informacionit nga poshtë-lart, sipas hierarkisë, është metoda më e përhapur e komunikimit (komunikimi nga vartësi te eprori, pra vertikal). Nga ana tjetër, titullari duhet t'u japë punonjësve informacionet e duhura, që këta të marrin vendimet e duhura si dhe të formulojë mesazhe dhe detyra të qarta e direkte për punonjësit, që këta të fundit t'i zbatojnë ato në mënyrën e duhur. Ekzistenca e një komunikimi horizontal efektiv është e një rëndësie esenciale për të marrë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave (rasti i hartimit të rregjistrit të taksapaguesve, rasti i hartimit të kontratave të qirave, etj.). Kjo kërkon një ndërveprim të mirë dhe shkëmbimin në kohë të informacionit ndërmjet strukturave, njësive dhe punonjësve të ndryshëm që gjenden në të njëjtin nivel të hierarkisë së njësisë.

Është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit me urdhrin nr.40, datë 15.10.2024, si dhe funksionon Faqja Eëb e institucionit, ku afishohen dokumente të ndryshme në kuadër të transparencës.

Nga titullari nuk janë përcaktuar rregulla për ruajtjen e informacionit elektronik.

Nuk është ngritur një sistem deklarimi efikas, i cili duhet të përfshinte nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen titullarit nga menaxherët kryesor, shpeshësia e këtyre raportimeve (për raporte, mujore, tre mujore etj.), në mënyrë që të vlerësohet dhe të mbikëqyret efienca dhe efektiviteti i veprimtarive të secilit sektor, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e të nenit 23 të MFK. Nuk ka të përcaktuar në detyrat e asnjë drejtorie apo sektori se çfarë raportesh duhet të përgatisë për titullarin dhe në çfarë intervali kohe duhet ti përgatisë.

Lidhur me gjurmën e auditimit, kjo është hartuar vetëm nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar por jo nga drejtorit dhe sektorët e tjerë të bashkisë.

Përgjegjësia për miratimin e gjurmës së auditimit i takon titullarit, ndërsa përgjegjësia për hartimin e tyre është e drejtorëve të drejtorive dhe përgjegjëseve të sektorëve, sipas strukturës së aparatit të Bashkisë Pukë për vitin 2024. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët (drejtorët e drejtorive), për proceset kryesore të punës dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Gjurmët e auditimit duhet të përfshijnë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Informacioni i marrë nga gjurma e auditimit i jep mundësinë titullarit, ose audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve që ndodhin brenda çdo procesi. Një gjurmë auditimi bën të mundur identifikimin e aktivitetëve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to. Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktivitetëve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese, etj.

Gjurma e auditimit pas miratimit duhet të arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Mos përgatitja nga menaxherët (drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve) i gjurmës së auditimit, për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë, është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2 dhe 3 Mangësitë e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 23.

Monitorimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

Elementët kryesor të monitorimit janë:

Monitorimi i përditshëm – kryhet nga menaxherët gjatë zbatimit të punës ditore (kontrolli mbi dokumente, vendime, veprime etj.).

Monitorimi periodik – përmes raporteve, analizave dhe vlerësimeve (muajore, tremujore, vjetore).

Përdorimi i treguesve të performancës – për të matur se sa mirë funksionojnë proceset.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm – për të parë nëse duhet rishikuar apo përmirësuar ndonjë pjesë e sistemit.

Përfshirja e auditimit të brendshëm – si një formë e veçantë e monitorimit të pavarur.

Është dërguar ne Ministrinë e Financës brenda afateve të përcaktuara pyetësorin e vetëvlerësimit të MFK me të gjithë komponentët e saj.

Janë hartuar raporte periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit, për të cilat është informuar titullari dhe këshilli bashkiak:

Drejtoria e Menaxhimit financiar bën raporte periodike 4/8/12 muajore.

Raportet 4 muajore janë dërguar ne MFE në mënyrë elektronike ndërsa 8/ muajore dhe 12 / muajore janë dërguar elektronike dhe shkresore se bashkua me analizën financiare dhe miratimin në këshill dhe konfirmim prefekturë (vendim këshilli bashkiak nr.43 date 16.10.2024, konfirmim prefekturë nr. 726/1 prot date 01.11.2024 dhe 12 muajori vendim nr 10 date 18.04.2025 konfirmim prefekturë 302/1 prot date 05.05.2025).

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nuk është ngritur një sistem i plotë i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, pasi nuk ka një paketë të plotë rregullash të shkruara për të gjithë elementët e këtij sistemi, veprime apo mos veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 9, 10, 11, 20, 21, 22, 23, 24, si dhe me Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.20216.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. Rr.D., por edhe drejtorët e drejtorive/sectorëve të aparatit të bashkisë (për mos hartimin e gjurmës së auditimit, mos përcaktimin në detyrat funksionale të numrit të raporteve dhe llojin e tyre që duhet të përgatisin për titullarin gjatë një viti, mos hartimin e rregjstrit të rriskut, mos hartimin e planit të trajnimeve që duhet të kryhen nga vetë bashkia, etj).

Auditi i Brendshëm

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm,

“Mbi auditimin Financiar për periudhën 01.01.2024– 31.12.2024”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të strukturës së miratuar konstatohet se:

-Struktura e miratuar për pozicionet e punës së Njësisë së Auditit të brendshëm është 3 persona;

1- Përgjegjës Sektori.

2- Specialistë

Bashkia Pukë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Në Bashkinë Pukë Njësia e sektorit të AB nuk është e plotësuar me asnjë punonjës e për pasojë është jo efiçente.

- Gjatë periudhës së auditimit, në Bashkinë Pukë struktura e sektorit të Auditit, nuk ka qenë e plotësuar. Neni 10 i ligjit Nr.114-date-22.10.2015-Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm përcakton se: Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të pëcaktuara në vijim:

a) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e auditimit të brendshëm, kur ka një të tillë të parashikuar në strukturën organizative të njësisë publike;

b) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror, ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat.

ç) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Njësia e auditimit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike. 2/1. Modeli i marrëveshjes ndërmjet titullarëve të njësive publike, si dhe i kontratës, kur kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm realizohet me kontraktim, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.

3. Njësia e auditimit të brendshëm krijohet në përputhje me kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit përgjegjës për financat.

Për sa më sipër është në kundërshtim me Neni 10 të ligjit Nr.114-date-22.10.2015-Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm.

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, për periudhën 01.01.2024 deri 31.12.2024 ngarkohen me përgjegjësi: z. Rr. D. me detyrë; Kryetar i Bashkisë Pukë.

2.2. Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.1. Auditim i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pozicionin financiar.

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre.

- Inventarizimi periodik.

2.2. Auditim i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme,

- Llogarive të pagueshme,

2.3. Auditim i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat;

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

-Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

- **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2024, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Qasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2024 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 7,930 mijë lekë për shpenzimet, sipas Pasqyrës bashkangjitur raportit të auditimit:

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë për vitin 2024 janë të nënshkruara nga z. Rr. D. me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. F.L. me detyrë Drejtor i Financës (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Pukë me shkresën nr. 710 prot., datë 26.03.2024, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 29.03.2024.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Pukë, mbahet me sistem *ALPHA*. Sektori i financës në Bashkia Pukë, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e Pasqyrave Financiare të Bashkisë Pukë, për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekset pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Pukë për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2024.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Pukë (pasqyrat financiare), Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
Aktivitet Neto janë të barabarta me Aktivitet - Pasive = Aktivitet Neto		1,712,327,116
Aktivitet		1,827,045,602
Pasivitet		-114,718,486
Aktivitet Neto		1,712,327,116

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

		Lekë
Aktivitet Afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën		233,364,875
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”		122,187,405
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		14,426,573
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		96,750,897

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

					Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2024-2024	
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0	
512,56	Mjete monetare në bankë	9,042,382	3,049,302	-5,993,080	
520	Disponibilitete në thesar	106,454,640	117,801,183	11,346,543	
50	Letra me vlerë				
532	Vlera të tjera	1,451,960	1,336,920	-115,040	
54	Akreditiva dhe paradhënie				
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)				
Totali		116,948,982	122,187,405	5,238,423	

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 117,801,183 lekë përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 101,170,514 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 16,630,669 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimin në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Në pasqyrën e mëposhtme paraqiten më hollësisht lëvizjet e llogarisë 520.

Llogaria 520 ne vitin 2024		Vlera /Lekë
I.Të trashëguara nga viti 2024		
Sipas aktit t ërakordimit për shumën. Nga të cilat:		
<i>Granti i trashëguar</i>		68,546,000
<i>Të ardhura të trashëguara</i>		23,581,841
<i>Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)</i>		
<i>Fonde specifike</i>		
<i>Jashte limiti</i>		
Totali		92,127,841
II.Tëhyrat (Shtesatdebitore) gjatë vitit 2024		
<i>Granti I vitit + Shtese per rritje page</i>		171,422,423
<i>Të ardhurat e vitit</i>		37,236,470
<i>Të hyra nga mjetet në ruajtje</i>		
<i>Grant ispecifik</i>		124,557,189
<i>Buxheti</i>		147,853,701
<i>Akt normative</i>		36,284,817
<i>Jashte limiti</i>		
Tot.		517,354,600
Totali I tëardhurave (I+II)		609,482,441
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520		
<i>Pagasigurime (600+601)</i>		257,946,025
<i>Shpenzime operative (602)</i>		50,861,505
<i>Subvencione (603)</i>		
<i>Transferim ekorente të brendshme (604)</i>		18,820,000
<i>Transferime korente me jashtë (605)</i>		
<i>Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)</i>		124,666,904
<i>Kredia (BKT) + Interesapërhuamarje (651)</i>		
<i>Investime (231)</i>		64,680,589
<i>Të dala nga mjetet në ruajtje (466)</i>		0
<i>Transferime korente te brendshme + transfertabuxhetin e vet (658,800+3,302,112+3,781,427+311,561+609,196)</i>		-8,663,096
Totali		508,311,927
Gjendja debitore (Saldi) (I+II) – III =		101,170,514

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

				Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2024-2024
31	Materiale	4,105,867	1,820,405	-2,285,462
32	Inventar i imët	10,743,620	11,209,579	465,959
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra	1,402,780	1,396,589	-6,191
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizgjone për zhvlerësimin e inventarit (-)			
Totali		16,252,267	14,426,573	-1,825,694

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 14,426,573 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 1,820,405 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 11,209,579 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,825,694 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në PF në vlerën 1,825,694 lekë. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar

duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2024 Bashkia Pukë**

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2024 për Bashkinë Pukë dhe Njësitë Administrative në varësi.

Inventari i vitit 2024.

Me shkresën nr. 2168 prot., datë 26.11.2024, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Urdhërin nr. 455 datë 26.11.2024, me objekt “Për ngritjen e komisionit të punës për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe njësisive vartëse.

Janë ngritur komisionet dhe janë përcaktuar dhe vendet ku do të ushtrohet inventarizimi si vijon: Bashkia, Klubi Sportiv, ndërmarrja e shërbimeve, shkolla e mesme, shkolla 9-vjecare, konvikti, kopështi, çerdhja, pyjorja dhe zjarrfiksjia.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastet e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023. Është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve. Nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 455, datë 26.11.2024 është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve, ku janë mbajtur procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.

Komisioni ka hartuar relacionin përmbledhës për mbledhjen e aktiveve jashtë përdorimi nga subjektet e inventarizimit dhe argumentimin e vlerësimit të tyre jashtë përdorimi. Rezulton se janë identifikuar aktive jashtë funksioni, në Bashki, Klub Sportiv, Shkollë 9-vjecare, Shkollë e mesme, Konvikt, Kopësht, Cerdhe, Pyjore dhe Zjarrfikëse ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

1. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,858,414 lekë.
2. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 803,347 lekë.
3. Llog.214 “Instalime Teknike, Pajisje, Instrumente dhe Vegla Pune” në vlerën 800,001 lekë.
4. Llog.215 “Mjete transporti” në vlerën 270,000 lekë.

Në objektin Pallati i kulturës, qendra sociale dhe QFK, janë identifikuar pajisjet sipas llogarive ekonomike si vijon:

1. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 76,450 lekë.
2. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 840 lekë.
3. Llog.214 “Instalime Teknike, Pajisje, Instrumente dhe Vegla Pune” në vlerën 800,001 lekë.

Në Njësinë Administrative Qelëz janë identifikuar pajisjet si vijon:

1. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 159,150 lekë

2. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 12,000 lekë.

Për vitin 2024 nuk ka nxjerrje jashtë përdorimi.

Situatani.1: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit rezulton se, nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJM. Ndërsa në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë rregjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet, kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare. Problematikë e mbartur që nga viti 2015 me bashkimin e ish/komunave.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III. Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes se tyre” pika 26, 27,30. Kreu IV. “Sistemi i kontrollit periodic të aktiveve Inventarizimi i aktiveve” pika 74, ku përcaktohet se: *Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

Shkaku: Mos kryerja e inventarizimit për AAGJM (Aktivet afatgjata materiale) dhe vlerësimi i gjendjes fizike në terren.

Ndikimi: Mangësi në përkatësinë dhe saktësinë e paraqitjes së aktiveve afatgjata në bilancin kontabël për këto llogari.

Rëndësia: E lartë

Sa më sipër mban përgjegjësi z. Rr.D., me detyrë kryetar i Bashkisë Pukë, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2023-2024
	Llogari të arkëtueshme	75,102,532	96,272,670	21,170,138
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes			
468	Debitorë te ndryshëm	51,376,834	48,503,919	-2,872,915
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	23,725,698	47,768,751	24,043,053
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
	Totali	75,102,532	96,272,670	21,170,138
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	480,316	478,227	-2,089
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	116,314,156	0	-116,314,156
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	30,633,989	0	-30,633,989
	Totali	147,428,461	478,227	-146,950,234

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 51,376,834 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 48,503,919 lekë. Vlera e debitorëve ne vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ka pësuar një ulje prej 2,872,915 lekë, e cila ka ardhur nga arketimi i

debitorëve të taksave dhe tarifave vendore. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarisë 468“Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2024

Lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	51,376,834
Shtesa (K)	4,314,929
Pakësime (D)	7,187,844
Gjendja debitorë në 31.12.2024	48,503,919

Në mënyrë të detajuar lista e debitorëve sipas kategorive paraqitet në tabelën më poshtë;

Lekë

Nr	Llogaria	Gjendja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësimet 2024	Gjendja ne fund 31.12.2024	Emërtimi i debitorit
1	468	14,285,080	-	-	14,285,080	Debitorë nga KLSH ndër vite
2	468	440,000	-	-	440,000	Debitorë nga APP
3	468	28,485,843	2,515,940	5,578,329	25,423,454	Tatim-Taksa-Tarifa
4	468	474,028	536,189	379,743	630,474	Banesa me kosto të ulët
5	468	108,682	-	-	108,682	Individe/ish komuna Qerret
6	468	205,058	1,172,800	1,195,685	182,173	Kopesht/cerdhe/konvikt
7	468	6,040,059	-	-	6,040,059	Vjedhjet ne ish/komuna para 2015
8	468	11,721	-	10,087	1,634	Diferenca inventari
9	468	462,000	90,000	24,000	528,000	Gjopa Policia Bashkiake
Totali		51,376,834	4,314,929	7,187,844	48,503,919	

-Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 48,503,919 lekë ka kundër partinë përkatëse në llogarinë 470 “Llogari në pritje – të ardhura për tu marrë”, e rakorduar me Thesarin, veprime në përputhje me *Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese pika 7 germa c “Për konstatimin paraprak të te drejtave për tu arkëtuar debitorët e klasës e klasës 4 (411-468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 ‘Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë’*. Lëvizja e llogarisë 468 debitorë të ndryshëm për vitin 2024, paraqitet më e detajuar në anekse bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

-**Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**, në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 47,768,751 lekë e cila rakordon për vlerën 47,768,751 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, e cila përbëhet nga shuma e : llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 9,341,031 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 18,775,187 lekë, llog.431 “Detyrime

ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,345,989 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 5,422,809 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 738,564 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	9,341,031
Paga personeli llogaria 42	18,775,187
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431	1,345,989
Sigurime shoqërore llogaria 435	5,422,809
Sigurime shëndetësore 436	738,564
Totali	47,768,751

II. AKTIVET AFAT GJATA MATERIALE

Aktivet Afatgjata Jomateriale.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

-**Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,137,600 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 79,043 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,017,614 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,137,600
	2	Amortizim i akumuluar	79,043
	3	Gjendja në 01.01.2024 Neto	1,058,557
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	6	Kosto historike	1,137,600
	7	Amortizim i akumuluar	157,871
		Gjendja më datë 31.12.2024	979,729

Burimi i të dhënave: *Bashkia Pukë.*

-Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në Bashkinë Pukë në datën 31.12.2024 përbëhet nga 5 studime e projektme në vlerën 1,058,557 lekë kosto historike, nga të cilat 593,835 lekë janë projekte të trashëguara që nga ish-komunat të pa zbatuar dhe realizuar, ndërsa 543,765 lekë janë projekte të hartuara gjatë vitit 2022-2023, por edhe këto të pa realizuara deri në fund të vitit 2024. Kjo llogari paraqitet në Pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Llogaria 202 kosto historike	Vlera në lekë
1	Studim projektim kanali Bushat	399,600
2	Studim projektim Ujesjellesi Bicaj	138,000
3	Studim projektim Ura Kavline	300,000
4	Studim projektim rruga Lumzi	300,000
5	Studim projektim kanali Bushat	399,600
	Totali	1,137,600

Burimi: *Bashkia Pukë*

2. Aktivet Afatgjata Materiale.

Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje., Terrene*” në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë pandryshuar nga vitit paraardhës. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF, si më poshtë:

	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Gropa mbeturinave F-Qarri Bashkëfinancim	475,231

2	Permiresim I gropes mbeturinave stadiumi fondaci ABC	331,414
3	Ndertim sheshi per mbledhje Njesia Gjegjan	396,000
Totali Bashkia+Njësité		1,202,645

Burimi: Bashkia Pukë

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë. Nga verifikimi dhe analiza e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale pasi nuk ka pasur një proces regjistrimi e vlerësimi për këtë llogari. Në kartelat e kontabilitetit nuk paraqitet asnjë prej vlerave të, trojeve nën objekt të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdheve, Shtëpisë së Kulturës, zyrave në Njësité Administrative etj., të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

-Gjendja e Llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2024 paraqitet në vlerën neto 5,327,189 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 4,261,750 lekë. Pakësimi në shumën 1,065,437 ka ardhur nga vlera e amortizimit të vitit. Për sa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave në zbatim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Pukë. Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk janë pasqyruar sipërfaqet e trajtuara më sipër, në kushte të tilla kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2024. *Vlera e mësipërme tregon vetëm vlerë kontabël të investimeve të kryera gjatë viteve por jo vlerën reale të kësaj llogarie ekonomike, pasi nuk ka një proces vlerësimi të këtyre asetëve, problematikë e mbartur prej vitit 2015 nga bashkimi me ish/komunat. Më poshtë paraqiten pasuritë e transferuara të cilat nuk janë të vlerësuara dhe të kontabilizuara.*

Llogaria. 211 “Pyje, kullota, plantacione”

Nr	Lloji i Pasurise	Nr. Pasuri	Nr. dok. hipoteko	Data e leshimit te certifiktes	Zona kadastral	Adresa	Sip truall m²	Shenim Tranferuar me VKM Nr
1	Pyllë	1120/2		8/8/2024	3070	Pukë	254,335	433, datë 08.06.2016
2	Shkembore(fond Pyjore)	701		12/4/2022	2229	Korthpule	23,183	433, datë 08.06.2016
3	Pyllë	425		10.10.2017	1786	Shkoze	402,500	433, datë 08.06.2016
4	Pyllë	424		10.10.2018	1786	Shkoze	362,500	433, datë 08.06.2016
5	Pyllë	422		26.06.2019	2992	Plet	8,770,000	433, datë 08.06.2016
6	Pyllë	423		26.06.2020	2992	Plet	720,000	433, datë 08.06.2016
7	Djerr	510		26.06.2021	2992	Plet	800,000	433, datë 08.06.2016
8	Pyllë	571		26.06.2022	2992	Plet	55,000	433, datë 08.06.2016
9	kullot	445		16.12.2021	1576	Dush	173,627	433, datë 08.06.2016
10	Pyllë	523		16.12.2022	1576	Dush	315,260	433, datë 08.06.2016
11	Shkembore(fond Pyjore)	515		16.12.2023	1798	Gomsiqe	30,238	433, datë 08.06.2016
12	Pyllë	764		12.04.2022	2509	Luf-pla	310,686	433, datë 08.06.2016
13	Kullote	498/1		27/06/2022	1798	Gomsiqe	380,000	433, datë 08.06.2016
14	Pyllë	1224/1		16.08.2022	3207	Rrape	257,672	433, datë 08.06.2016

15	Pylle	165/1		26.06.2017	1586	Duzhnez	97,500	433, datë 08.06.2016
16	Pylle	512		02.07.2019	2130	Kcire	642,500	433, datë 08.06.2016
17	Pylle	424		02.07.2019	2992	Plet	387,500	433, datë 08.06.2016
18	Pylle	511		02.07.2019	2130	Kcire	955,000	433, datë 08.06.2016
19	Pylle	748/3		16.03.2023	2509	Luf-pla	585,046	433, datë 08.06.2016
20	Pylle	750		12.04.2022	2509	Luf-pla	33,058	433, datë 08.06.2016
21	Pylle	757		12.04.2023	2509	Luf-pla	419,585	433, datë 08.06.2016
22	Shkembore(fond Pyjore)	191		19/07/2024	1219	Blinisht	90,000	433, datë 08.06.2016
23	Pylle	186		19/07/2025	1219	Blinisht	51,490	433, datë 08.06.2016

Në pasqyrën e mëposhtëme janë vlerat e investimeve të kryera, të paraqitura në kontabilitet në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” vlera neto.

Analiza e paraqitur në kontabilitet.

	Analiza e Llogarisë 211	Neto 01.01.2024	Shtesa 2024
1	Pyllezime me akacie fshati Qelez	277,460	-
2	Pyllezime me geshtenje dhe lajthi shpati I kishes Qelez	233,915	-
3	Pyllezime me dru dekorativ ne varrezat e fshatrave Kalivare dhe Gjegjan	417,683	-
4	Pyllezime me arre dhe akacie ek pyjore Buhot, Bicaj	618,382	-
5	Gjelberimi Luf Komuna Luf -Qerret	75,497	-
6	Dru frutore Komuna Qerret	387,831	-
7	Pyllezime Gomsiqe Komuna Qerret	506,805	-
8	Pyllezimme Luf Komuna qerret	308,686	-
9	Pyllezimme Luf-Kcire Komuna Qerret	466,342	-
10	Blerje fidane kodra e hanit	98,304	-
11	Blerje Fidane Puke	50,381	-
12	Punime pyje Munelle,Luf ,Qelez,Rrape	424,121	-
12	Pyllezim hapje gropa qafe Qerreti Qelez	182,784	-
13	Punime ne pyje mure mbajtëse Rrape Breg	213,559	-
	Gjendja më datë 31.12.2024	4,261,750	-

-Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione” më datën 01.01.2024, paraqitet në vlerën neto 637,399,292 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,935,970 lekë, rikonstruksione në ndërtesës pyjore, ndërtesës së bashkisë, shkolla e mesme Gjegjan, ndërtesa e MZSH, dhe shkolla e mesme Gomsiqe. Pakësim në vlerën (13,868,681) lekë si pasojë e sitemimit të veprimeve kontabël për objektet: Investim në “Pallatin e Kulturës” në vlerë 2,900,424 lekë, “Banesa Sociale” në vlerën 5,500,000 lekë dhe objektin “Qendra Rinore” në vlerën 5,468,257 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 31,480,550 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 595,495,877 lekë.

Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtime Konstruksione”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	889,514,502
	2	Amortizim i akumuluar	252,115,210
	3	Gjendja në 01.01.2024	637,399,292
	2	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	2,935,970
	3	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	13,868,681
	4	Kosto historike	878,581,791
	5	Amortizim i akumuluar	283,085,914

6	Gjendja më datë 31.12.2024	595,495,877
---	----------------------------	-------------

- Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,125,914,806 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,150,800,971 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 104,647,418 lekë, e përbërë nga objekti: Ujësjetllës i fshatit Luf dhe pakësime (sistemim) në vlerë (79,761,253) lekë që I përket objektit: Ujësjetllës i fshatit Gjeggjan. Kjo lëvizje ka ndodhur si pasojë e sistemimit në kontabilitet të kësaj vlere, e cila është *konstatuar dhe rekomanduar nga KLSH në auditimin e mëparshëm të periudhës nën auditim të vitit 2023 në bashkinë Pukë*. Amortizimi për vitin 2024 është llogaritur 513,102,656 lekë.

Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,125,914,806
	2	Amortizim i akumuluar	479,568,031
	3	Gjendja në 01.01.2024	646,346,775
	2	Shtesa gjatë vitit 2024 (D) Sistemuar Sipas rekomandimeve të KLSH	104,647,418
	3	Pakësime gjatë vitit 2024 (K) Sistemuar Sipas rekomandimeve të KLSH	79,761,253
	4	Kosto historike	1,150,800,971
	5	Amortizim i akumuluar	513,102,656
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	637,698,315

PASURITË E PALUAJTSHME

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin, një proces që përfshinte hartimin e inventarit paraprak, afishimin dhe përditësimin e pasurive dhe në fund miratimin e listës përfundimtare të pronave me vendim të Këshillit të Ministrave.

Lista përfundimtare e pronave të transferuara në Bashkinë Pukë

Nr	Njësia e Qeverisjes vendore	VKM		Në total	Ne pronësi	Ne përdorim	Nga këto te regjistruara
		Nr.	Date				
1	Bashkia Puke	140	23.02.2011	199	154	45	8
2	Ish-komuna Qelëz	648	31.7.2013	56	41	15	2
3	Ish-komuna Rrape		Nuk ka VKM për miratimin e listës përfundimtare				
4	Ish-Komuna Gjeggjan		Nuk ka VKM për miratimin e listës përfundimtare				
5	Ish-komuna Qerret		Nuk ka VKM për miratimin e listës përfundimtare				
Totali				255	195	60	

Për Bashkinë Pukë, lista përfundimtare e pronave është miratuar me VKM nr.140 datë 23.02.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pukë, të qarkut të Shkodër, nga ku rezultojnë pronat të natyrës si mëposhtë:

- Pronat me funksion administrativ **në pronësi** me numër rendor 5, 7-14, 17-21, 28, 34 në total 15
- Prona me funksion arsimor **në pronësi**, me numër rendor 38-47 në total 10 pasuri

- Prona me funksion shërbimi shëndetësor **në pronësi**, me numër rendor 55,56, në total 2 pasuri
- Pronat me funksion social-kulturor **në pronësi** , me numër rendor 57-64, në total 8 pasuri
- Prona që përdoren për strehim **në pronësi**, me numër rendor 65-88, në total 24 pasuri
- Prona me funksion shërbimi social **në pronësi** me numër rendor 89, në total 1 pasuri
- Prona me funksion varreza **në pronësi** me numër rendor 90-94, në total 5 pasuri
- Prona me funksion troje të lira, sheshe **në përdorim** me numër rendor 95-101;111-144;146-148;160, në total 45 pasuri
- Prona me funksion infrastrukture **në pronësi**, me numër rendor 102-110;145 në total 10 pasuri
- Prona me funksion të zhvillimit ekonomik **në pronësi**, me numër rendor 149-158;165-166, në total 12 pasuri
- Prona me funksion rrugë **në pronësi**, me numër rendor 159;406-419 në total 15 pasuri
- Prona me funksion bujqësore toka produktive në përdorim , me numër rendor 171-174, në total 4 pasuri
- Prona me funksion ujësjellës kanalizime **në pronësi**, me numër rendor 392-395, në total 4 pasuri
- Prona me funksion për ndriçimin publik **në pronësi**, me numër rendor 422-465, në total 44 pasuri.

Prona të regjistruara

Nr	Emërtimi i pronës	Nr. Pasuri	Data e regjistrimi	Zona kadastral	Adresa	Sip truall m ²	Sip nd. m ²	Pasqyruar ose jo ne bilancin e Bashkisë.
1	Ndërtesë 2-katëshe	1/253	03.03.2022	3069	Pukë	190	150	PO
2	Godinë 4 -katëshe Bashkia Pukë	1/233	03.03.2022	3069	Pukë	666	440	PO
3	Godinë Shkollë e Mesme Qelëz	47/4	25.05.2022	3092	Ish-komuna Qelëz	800	800	Jo
4	Zyrat e PLL-se Njësi	1/236-N1	11.05.2023	3069	Pukë	0	16	PO
5	Zyra e Komunës Qelëz	1050	04.03.2022			153	153	
6	Zyrat e Konfederatave te pavarura	1/236N2	11.05.2023	3069	Pukë	0	14.6	PO
7	Shtëpia e Oficerëve	1/383	01.07.2022	3069	Pukë	2580	633	PO
8	Kopshti i fëmijëve	145	23.01.2023	3070	Fshat Pukë	281	102	PO
9	Njësi						54	
10	Godina e Ish fjetores	Janë hapur kartelat si apartamenti si mëposhtë				-	-	
10	godina e Ish Fjetorja N.N apartamenti	1/325+4-2	19.01.2023	3069	Pukë	0	85	PO
11	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+4-1	19.01.2023	3069	Pukë		65	PO
12	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+1-1	19.01.2023	3069	Pukë		65	PO

13	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+2-1	19.01.2023	3069	Pukë		65	PO
14	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+1-2	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë,Pukë		65	PO
15	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+2-2	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë,Pukë		85	PO
16	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+3-1	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë,Pukë		65	PO
17	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+3-2	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë,Puke		85	Po

Sa i përket certifikatave të pronësisë, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të sakta mbi numrin real të regjistrimit. Asnjë drejtori në Bashkinë Pukë nuk është e ngarkuar me këtë detyrë.

Në lidhje me pasurinë nr.47/4, zona kadastrale 3092 me sipërfaqe 800 m² truall dhe 800 m² ndërtesë, objekti gjimnazi, ish-Komuna Qelëz rezulton se në certifikatën e pronësisë mungon sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës. Kjo pasuri i përkon numrit rendor 621 të inventarit me sipërfaqe 1800 m² truall dhe 800 m² ndërtesë. Si pasojë, rezulton një sipërfaqe 1000 m² më pak sesa inventari, për të cilën në Bashkinë Pukë nuk administrohet asnjë informacion nga Zyra Vendore e ASHK Pukë për arsyet e kësaj diference.

Ish-Komuna Qelëz, aktualisht njësi administrative

Lista përfundimtare e pronave është miratuar me VKM nr. 648, datë 31.7.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës”, nga ku rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

- Prona për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative **në pronësi**, me numër rendor 554, në total një 1 pasuri;
- Prona për realizimin e programeve arsimore **në pronësi**, me numër rendor 555-561, 621, në total 8 pasuri ;
- Prona për realizimin e funksioneve në shëndetin publik **në pronësi**, me numër rendor 562;563 në total 2 pasuri;
- Prona për realizimin e funksioneve në infrastrukturë **në pronësi** me numër rendor 564-575 në total 12 pasuri;
- Prona me funksion varreza publike në pronësi, me numër rendor 576-585 në total 10 pasuri;
- Prona me funksion të ujësjellës-kanalizime në pronësi, me numër rendor 586-592, në total 7 pasuri;
- Prona me funksion bujqësore toka produktive **në përdorim**, me numër rendor 604-618 në total 15 pasuri;
- Prona me funksion për zhvillim ekonomik **në pronësi**, me numër rendor 620 në total 1 pasuri;

Për Bashkinë Pukë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Pukë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Në strukturën e bashkisë dhe rregulloren e brendshme nuk përcaktohen asnjë sektor apo specialist për ushtrimin e funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

- Në territorin administrativ të bashkisë Pukë, janë miratuar lista përfundimtare e pronave vetëm për bashkinë dhe ish-komunën Qelëz. Tre ish-komunat, Gjegjan, Rrape dhe Qerret nuk kanë listë përfundimtare të pasurive të paluajtshme të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Pukë nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se *“bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”*.
- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Pukë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë.
- Në bashkinë Pukë nuk ka një sektor që mbulon çështjen e pasurive të paluajtshme të transferuara, sikurse përcaktohet në VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”. Struktura e posaçme ka si funksion bashkëpunimin me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga neni 37, i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Në total, nga 255 pasuri i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Pukë, pa përfshirë ish-komunat, vetëm 10 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Nga evidencat e shqyrtuara konstatohet se sa i përket certifikatave të pronësisë, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të sakta mbi numrin real të regjistrimit.
- Në veçanti konstatohet vërehet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to ka realizuar investime përgjatë viteve, për Bashkinë Pukë.

Situata nr. 2 Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, janë të pa analizuara në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit, për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat e paraqitura në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive. *Vlen të theksohet se në Buxhetin*

Vjetor të vitit 2024 nuk janë parashikuar fonde për nisjen e procedurave për regjistrimin e aseteve të institucionit.

Kritere: Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe Udhëzimi nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Shkaku: Mos kryerje e procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe kontabilizimi të aktiveve afatgjata.

Ndikimi: Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Rëndësia: E Lartë

Për sa më sipër llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk paraqet një pamje reale të pasqyrave financiare të vitit 2024.

- **Gjendja e Llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 30,214,458 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 648,246 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 17,055,767 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,806,937 lekë në vlerë neto.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	30,862,704
	2	Amortizim i akumuluar	17,055,767
	3	Gjendja në 01.01.2024	13,806,937
	2	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	340,800
	3	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	2,787,082
		Kosto historike	31,203,504
		Amortizim i akumuluar	19,842,849
		Gjendja më datë 31.12.2024	11,360,655

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 43,580,238 lekë kosto historike. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 4,836,000 blerje automjeti tip fadrome. Poashtu ka pasur dhe një shtesë të një automjeti tip (Ambulancë) në vlerë 730,000 lekë. Vlera prej 730,000 lekë është pjesë e 10% të vlerës totale financuar nga bashkia me marrëveshje, pasi pjesa tjetër është donacion nga fondacioni I. Automjeti është bërë bërë hyrje me FH nr.4 datë 08.03.2024. Amortizim të akumuluar në vlerën 29,073,205 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja neto e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 20,073,033 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 215 “Mjete Transporti”

EMERTIMI	Vlere historike	Shtesa 2024	Paksime 2024	Vlera Neto 2024
Komion teknologjik tip "Volo" targe Tr 8826R,	3,480,000	0	0	183,912
Makine Teknologjike per mbetjet tip Renault ngjyre e bardhe Nr. Shasise VF644ACA000004277	2,820,000	0	0	557,096
Makine "Foristrade"	2,070,000	0	0	-

Mercedes Benz 'ML' ngjyre gri Nr.Shasise ĒPC 161131MA 275250	650,000	0	0	1128,408
Rover AA339AR ngjyre e bardhe . Nr.Shasise SALLJGMF8VA543058	270,000	0	0	53,339
Kompatator	2,940,000	0	0	-
Kamionçine me targe SH808IE,Nr shasise DAIMLER,ĒDB9044121P90036	960,000	0	0	393,216
Kamion me targe AA681MO,Nr shasise ĒMAT040600M2585527	4,020,000	0	0	1,646,592
Mjet Zjarrfikese MAN	20,400	0	0	-
Mjet Zjarrfikese Steyer	700,000	0	0	77,511
Mjet Zjarrfikese Ford Tranzit	480,000	0	0	80,933
Mjet tip Steyr-- PUCH Pinzgrauer 712, Nr Shasie 47538337 , Targa PU 15185 A	350,000	0	0	91,571
SAURER Automjet nr.shasie 201778317 Viti 1964	5,470,000	0	0	197,354
Land Rover ngjyre blu e erret NR. Shasise SALLJGMF8VA543058	380,000	0	0	75,071
Makine	350,000	0	0	-
Mercedes BENZ GLE 350,VITI 2016	3,880,000	0	0	1,986,560
Automjet Furistrade	1,150,800	0	0	736,511
Blerje fadrome	2,514,000	0	0	2,011,200
AUTOMJET MICUBISH L 200	11,075,038	0	0	7,306,491
Automjet Teknologjik Fadrome		4,836,000		3,950,722
Ambulance		730,000		596,366
Gjendja në 01.01.2024	43,580,238	5,566,000		20,073,033

-Nga auditimi i Pasqyrës 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 215 “Mjete transporti” për vitin ushtrimor 2024 është përlllogaritur në rregull norma e amortizimit. Veprime këto në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2024, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme Gjendja e **Llogarisë 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 68,056,740 lekë kosto historike. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesë në vlerën 3,248,560 lekë (blerje me pagesë). Pakësim në vlerë 55,238,450 vlerë historike lekë amortizim i akumuluar, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,066,850 lekë vlerë neto.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik”	Vlera lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	68,056,740
	2	Amortizim i akumuluar	51,322,705
	3	Gjendja në 01.01.2024	16,734,035
	2	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	3,248,560
	3	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	4	Kosto historike	71,305,300
	5	Amortizim i akumuluar	55,238,450
	6	Gjendja neto më datë 31.12.2024	16,066,850

Aktivet Afatgjata Financiare:

Aktivet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 140,923,000 lekë. Gjatë ka pasur pakësime në vlerën 137,423,000 lekë si pasojë e transferimit të UKP drejt SH.R.U.SH (Shoqëria Rajonale e Ujësjetës të qarkut Shkodër) sh.a.

Vlera prej 3,500,000 lekë përbëhet nga vlera e aksioneve të Futboll Klub Tërbuni Sh.a. dhe kjo kuadron dhe rakordon me vlerën e pasqyrar në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Lidhur me Futboll Klub Tërbuni Sh.a, bashkia Pukë, me Vendim të këshillit bashkiak (VKB) nr. 12 datë 18.04.2025 nr.664/2 prot., ka miratuar fillimin e shitjes me ankand në masën 100% të aksioneve që Bashkia Pukë i zotëron si aksionere e vetme. Poashtu me shkresë nr.945/3 prot., datë

03.06.2025 Bashkia Pukë ka kryer njoftimin e ankandit dhe ka përcjellë në APP (Agiensia e Prokurimeve Publike) me shkresë nr.945/4 kërkesën për botim në buletin e njoftimeve publike këtë procedurë.

-Gjendja e **llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në çelje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 244,905,059 dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 303,041,871 lekë, për të cilën u paraqit analiza e mëposhtme:

Llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”		Lekë
Çelje e vitit 2024		244,905,059
Shtesa (K)		58,136,812
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		303.041,871

Në total **llogaria 231** punime në proces (ndërtesa konstruksione + rruge rrjete dhe vepra ujore) paraqitet në fillim të vitit 2024 në vlerën debitorë prej 244,905,059 lekë. Për vitin 2024 është është kredituar për vlerën prej 58,136,812 lekë dhe rezulton me teprice debitorë në fund të vitit 2024 për vlerën prej 303,041,871 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të thesarit me të dhënat e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, rezulton që llogaria 231, sipas thesarit për vitin 2024 është në vlerën 303,041,871 lekë që rezulton e përputhur me vlerën debitorë të llogarisë 231 sipas DMF në bashkinë Pukë, për vitin 2024.

PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

- Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Pukë më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2023	Viti 2024
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	14,655,544	9,341,031
42	Detyrime ndaj personelit	13,826,786	18,775,187
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	669,936	1,345,989
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	3,982,435	5,422,809
436	Sigurime Shendetstore	543,375	738,564
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	14,326,318	16,630,669
467	Kreditore te ndryshem	20,681,611	12,145,171
4341	Operacione me shtetin(detyrime	0	0
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
Llogari të pagueshme		68,686,005	64,399,420

-Situata nr.3: Nga auditimi i pasiveve afatshkurtra u konstatua se: Gjendja e llogarisë 401-408 **“Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën

14,655,544 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 9,341,031 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje me një pakësim në shumën 5,314,513 lekë krahasuar me vitin 2023 duke qenë se janë likuiduar disa detyrime të prapambetura gjatë vitit 2024. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie janë konstatuar 92 raste të cilat i përkasin periudhës kohore para muajit Nëntor-Dhjetor 2024 në mbyllje të vitit ushtrimor, në vlerë 8,205,842 lekë. Kjo vlerë nuk është detyrim afatshkurtër e për pasojë duhej të paraqitej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Pasi kur *Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale*:

- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë”.

Në mënyrë të detajuar faturat në *Aneksë* bashkëlidhur PRA.

Kritere: Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III pika 3.1 nën pikë 42, Aneksi 1 pika 3.3/c,

Shkaku: Plotësim I gabuar në pasiv të bilancit të llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Ndikimi: Për pasojë llogaria 467 rezulton të jetë nënvlerësuar në shumën 8,205,842 lekë dhe deformon saktësinë e të dhënave në pasqyrën e pozicionit financiar të bilancit kontabël.

Rendësia: E Lartë

-**Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 18,775,187 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”		Lekë
Çelje e vitit 2024		13,826,786
Shtesa (K)		4,948,401
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		18,775,187

-**Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 1,345,989 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj Shtetit për muajin dhjetor 2024.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”		Lekë
Çelje e vitit 2024		669,936
Shtesa (K)		676,053
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		1,345,989

-**Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** dhe **llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 5,422,809 lekë dhe 738,564 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”		Lekë
Çelje e vitit 2024		3,982,375
Shtesa (K)		1,440,374
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		5,422,809
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”		
Çelje e vitit 2024		543,375
Shtesa (K)		195,189
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		738,564

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Pukë në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 16,630,669 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Pukë.

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2024	14,326,318
Shtesa (K)	2,309,101
Pakësime (D)	4,750
Gjendja në 31.12.2024	16,630,669

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë

Konstatohet se: Për disa objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Pukë janë ngurtësuar fonde për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Pukë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, për të njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në mos përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2024, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018”, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket, **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** paraqitet në rubrikën e anekseve, bashkëlidhur akt-konstatimit.

- Gjendja e Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara vendime gjyqësore të cilat në çelje të vitit 2024 janë në vlerën 20,681,611 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 5,712,400 lekë dhe pakësime në vlerën 14,248,840 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 12,145,171 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës, pasi nuk janë përfshirë detyrimet për shërbime në vlerë 4,952,357 lekë dhe investime në vlerë 3,253,485 lekë. Ato janë përfshirë gabimisht në llogarinë 401-408 si detyrime afatshkurtra. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” ka mospërputhje në saktësinë e pozicionit financiar e cila në çelje duhej të ishte 30,633,989 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 20,351,013 lekë. Nga ky veprim nuk ka ndikim në vlerën e totalit të pasiveve (detyrimeve), pasi në shumatore ato ekzistojnë dhe janë të raportuara dhe në MF (Ministrinë e Financave) në paraqitjen vjetore të raportit të vetvlerësimit financiar për katërmujorin e tretë, me shkresë Nr.346 prot., datë 12.02.2025. Të dhënat e detyrimeve e raportuar në MF paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Nr	Llogaria	Tipologjia e detyrimit	Gjendje me 01.01.2024	Shtesa	Pakesime	Gjenja me 31.12.2024
1	4864200	Det prap per sherbime	4,997,777	-	45,420	4,952,357
2	4864400	Det prap invetime	4,954,601	-	1,701,116	3,253,485
3	4864100	Det prap v.gjyqesore	20,681,611	5,712,400	14,248,840	12,145,171

Total	Shuma	30,633,989	5,712,400	15,995,376	20,351,013
-------	-------	------------	-----------	------------	------------

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

PF.10 “Detyrime për vendime gjyqësore”

Nr	Emri i Furnitorit	Numri dok	Data e Fatures	Lloji detyrimit	Pershkrimi	Gjendje me datë 31.12.2023	VEPRIME VITI 2024		Shuma e papaguar ne 31 dhjetor 2024
							Shtesa viti 2024	Likujdime viti 2024	
1	U. P. (Perambarimi E. M.)	206	21.12.2011	Largim nga puna	Vendim gjyqësor	134,000	-		134,000
2	B. shpk	206	21.12.2011	Det kontrate sherbimi	Vendim gjyqësor	1,440,001	-	1,440,001	-
3	Z. (permbaues)	17	17.01.2017	Detyrim kopesti dhe qendra sociale	Sherbbim permbaues	457,511	-		457,511
4	U. N.		18.10.2017	Det Rigjenerim shetitore	Permbaues	18,650,099	-	12,518,839	6,131,260
5	L.D.	437	29.05.2024	Largim nga puna	permbaues D.E.	-	443,200		443,200
6	V.GJ	339	21.05.2018	Largim nga puna	permbaues D.M		546,638	40,000	506,638
7	A.D.	611	11.07.2024	Largim nga puna	permbaues G.B.		1,539,378		1,539,378
8	N.B.	392	21.05.2024	Largim nga puna	Permbaues		723,184	250,000	473,184
9	H.R.	180	26.03.2023	Prishje objekti	V. gjyqësore		2,460,000		2,460,000
Shuma Totale 31.12.2024				0	-	20,681,611	5,712,400	14,248,840	12,145,171

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore, praktika të cilat kanë sjellë humbjen e proceseve gjyqësore, si dhe bënë të mundur evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Situata nr. 4: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, vlera të cilat nuk rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërpartit 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitur në aktiv të bilancit në vlerë 51, 376,834 lekë në fund të vitit 2023 dhe 48,503,919 lekë në mbyllje të vitit 2024. **Llogaria 4341** "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në Pasqyrat Financiare të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe perfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: Pasi ka ndodhur situata dhe është bërë veprimi kontabël: Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion); Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar. E ardhura në fund te periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi: Debitohet llogaria 8424 "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm"; Kreditohet llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)".

Kritere : Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Aneksi 1 "Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)". Seksioni: “Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin” gërma, a, b dhe c.

Ndikimi: Mosfunksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me saktësinë e debitorëve të konstatuara për periudhat e ardhshme në aktiv të bilancit, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me rakordimin aktiv-pasiv të bilancit, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar nuk është kryer saktë kontabilizimi i të ardhurave e të konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

Rëndësia: E Mesme

TË ARDHURAT

Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 11,076,473 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 12,473,854 lekë me një rritje në vlerën 1,397,381 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	01.01.2023	31.12.2024
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	11,076,473	12,473,854
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	27,500	122,569
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	27,500	122,569
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	1,885,093	2,851,160
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	1,839,115	2,851,160
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	45,978	
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	9,143,630	9,495,325
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	9,143,630	9,495,325
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	0	0
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksat mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksat kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

Të ardhurat jo tatimore:

-Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 13,898,688 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 18,676,608 lekë me një rritje në vlerën 4,777,920 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	01.01.2023	31.12.2024
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	13,898,688	18,676,608

710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,639,276	10,576,777
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,639,276	10,576,777
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	7,259,412	8,099,831
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	5,565,266	6,672,978
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,264,543	1,353,385
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	10,000	35,000
7114	Të ardhura nga biletat		0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	419,603	38,468
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore		

Për vitin 2024 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **56,161 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **37,236 mijë** lekë, ose 66% rreth 18,925 mijë lekë më pak nga plani.

Në krahasim me vitin 2023 kemi rritje të planit të të ardhurave në vlerë 9,779 mijë, ose 21%.

Auditimi në lidhje me të ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e të ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performances financiare të bashkisë Pukë.

Nga kryqëzimi i informacionit të thesarit, sektorit të takasve dhe tarifave vendore dhe rakordimi me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar u konstatua që nuk ka devijime në pasqyrimin e të ardhurave. Tabela e planifikimit e realizimit të ardhurave të veta paraqitet në anekse bashkëlidhur *Raportit të Auditimit*.

Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 444,499,590 lekë ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 522,069,363 lekë me një rritje në vlerën 77,569,773 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2024
72	V. GRANTE KORENTE	444,499,590	522,069,363
720	1. Grant korent i brendshëm	444,499,590	522,069,363
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	396,558,982	468,214,704
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	4,214,910	4,686,808
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	23,725,698	47,768,751
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	1,399,100
7209	Të tjera grante korente të brendshme	20,000,000	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
	Nga Qeveri të huaja	0	
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

Të ardhurat janë regjistruar dhe rakordojnë me të dhënat e thesarit dhe bilancin kontabël poashtu.

-SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 178,008,627 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 226,393,176 lekë me një rritje në vlerën 48,384,549 lekë, si pasojë e rritjes së pagave bazuar në VKM nr.328 datë 31.05.2024.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 29,450,812 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 38,145,028 lekë me rritje në vlerën 8,694,216 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Pukë me të njëjtën vlerë. Analiza sintetike për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	178,008,627	226,393,176
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	26,464,613	34,227,646
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	2,986,199	3,917,382
Totali		207,459,439	264,538,204

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 36,608,864 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 50,861,505 lekë me rritje në vlerën 14,252,641 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Pukë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2024
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	36,608,864	50,861,505
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,223,888	1,790,358
6021	Materiale dhe shërbime speciale	5,092,226	4,920,527
6022	Shërbime nga të tretë	9,019,660	11,898,589
6023	Shpenzime transporti	9,020,879	9,330,334
6024	Shpenzime udhëtimi	1,354,541	1,596,920
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	789,480	28,800
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	5,009,707	14,342,318
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	5,098,483	6,953,659

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Pukë nuk ka pasur subvencione.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 18,820,100 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 116,003,808 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2024
V. TRANSFERIME KORENTE		127,797,300	134,823,908
604	1. Transferita korente të brendshme	21,159,330	18,820,100
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë		
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	2,795,330	800,000
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	40,000	41,225
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	18,324,000	17,978,875
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare		
6052	Transferime për qeveritë e huaja		

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2024
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja		
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit		
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	106,637,970	116,003,808
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	106,637,970	116,003,808

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 609,482,441 lekë dhe totali shpenzimeve është 508,311,927 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 101,170,514 lekë kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 101,170,514 lekë e rakorduar me thesarin. Akt-rakordimet paraqiten në *anekse* bashkëlidhur Raportin e Auditimit.

Nga testi kontrollit për vitin 2024 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet e arkëtimit kryhen me arkë, për të gjitha rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, pagesat e kopshtit, ujit të pijshëm, tarifave të biznesit...etj, dhe në fund të çdo jave derdhjet e arkës bëhen në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" dhe kreut III pika 34 dhe 35 geramat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3, të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "*Për limitin e arkës*".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/kryetari dhe kryetari.

- Janë hapur kartela e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësive në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Konkluzione të përgjithshme

-Nga auditimi i pasiveve afatshkurtra u konstatua se: Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 14,655,544 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 9,341,031 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje me një pakësim në shumën 5,314,513 lekë krahasuar me vitin 2023 duke qenë se janë likujduar disa detyrime të prapambetura gjatë vitit 2024. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie janë konstatuar 92 raste të cilat i përkasin periudhës kohore para muajit Nëntor-Dhjetor 2024 në mbyllje të vitit ushtrimor, në vlerë 8,205,842 lekë. Kjo vlerë nuk është detyrim afatshkurtër e për pasojë duhej të paraqitej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Për pasojë llogaria 467 rezulton të jetë nënvlerësuar në shumën 8,205,842 lekë dhe deformon saktësinë e të dhënave në pasqyrën e pozicionit financiar të bilancit kontabël.

-Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, janë të pa analizuar në kontabilitet, në regjistrin kontabël ku specifikohen analitikët e këtyre zërave, nuk ka informacion të trashëguar për secilin aktiv, në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet. Pra na japin arsye të kemi rezerva mbi mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

- Nga auditimi i llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, gjendja kontabël është paraqitur si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë, vlera të cilat nuk rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërparti 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitur në aktiv të bilancit në vlerë 51, 376,834 lekë në fund të vitit 2023 dhe 48,503,919 lekë në mbyllje të vitit 2024. Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" është nënvlerësuar në shumën 48,503,919 lekë dhe nuk paraqet gjendjen reale në pozicionin financiar në bilancin kontabël 2024.

Përsa më sipër për anomalitë dhe mangësitë e konstatuara, ngarkohen me përgjegjësi: zj. F.L., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, z.Rr.D. me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit me objekt “Verifikimin e ecurisë së zbatimeve të rekomandimeve të lënë në auditimin e mëparshëm”, u krye audirimi zbatimit të rekomandimeve.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Pukë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 618/7 prot., datë 31.07.2024, ndërsa nga Bashkia Pukë për zbatimin e

rekomandimeve të KLSH. Me anë të shkresës nr. 980/19 prot., datë 21.08.2024 është kthyer përgjigje nga Bashkia Pukë. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda 20 ditësh, brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Pukë është hartuar Plan-Vepimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).

3. Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Pukë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.618/7 prot., datë 31.07.2024 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 31.01.2025

Nga ana e Bashkisë Pukë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Nuk është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.*

3. Rekomandimet e KLSH-së

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Pukë nga KLSH me shkresën nr. 618/7 prot., datë 31.07.2024 janë rekomanduar gjithsej:

*a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **18** masa organizative (për 15 gjetje), nga të cilat janë pranuar plotësisht **18** masa, janë zbatuar plotësisht 11 masë, zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatimi 1 masë, nuk janë zbatuar **5** masa organizative.*

b. Për shpërblim dëmi nuk janë rekomanduar masa.

B. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet. Një (1) masë në vlerën **277,091 lekë**, e pranuar dhe e pa zbatuar.

D. Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash. Pesë (5) masa në vlerën **29,721,210 lekë**, të pranuar, prej të cilave një e zbatuar (në vlerën 102,000 lekë) dhe 4 masa në proces zbatimi.

C. Për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e atakuar në seksionin Masa Disiplinore, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil. I është rekomanduar që të ngrejë komisionin disiplinor për 4 punonjës, e pranuar dhe e zbatuar në 1 raste. Pa zbatuar 3 raste.

Në tabelat e mëposhtme jepen të grupuara masat e dhëna dhe zbatimi i tyre nga Bashkia Pukë.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Pukë

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	18	18	0
Masa për shpenzime pa ekonomikitet (3E)	1	1	0
Masa të ardhura të munguara	5	5	0
Masa disiplinore	4	4	0
Totali	28	28	0

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	18	18	11	1	1	5
% e realizimit në numër për masat organizative	100%	100%	61%	6%	6%	28%
Masa për shpenzime pa ekonomikitet (3E)	1	1	0	0	0	1
% e realizimit në numër për masat 3E	100%	100%	0	0	0	100%
Masa të ardhura të munguara	5	5	1	0	4	0
% e realizimit në numër për masat e të ardhurave të munguara	100%	100%	20%	0	80%	0
Totali në numër: Masa organizative, 3E në shpenzime dhe të ardhura të munguara	24	24	12	1	5	6
Totali në %: Masa organizative, 3E në shpenzime dhe të ardhura të munguara.	100%	100%	50%	4%	21%	25%
Masa disiplinore	4 masa (vërejtje)	4	1	0	0	3
Zbatimi i masave disiplinore në %	100%	100%	25%	0	0	75%
Totali në numër: Masa organizative dhe të ardhura të munguara dhe masa disiplinore	28	28	13	1	5	9
Totali në %: Masa organizative dhe të ardhura të munguara dhe masa disiplinore	100%	100%	46%	4%	18%	32%

Për masat e ri kërkuara nga auditimi i mëparshëm

Gjithashtu në auditimin e mëparshëm është ri kërkuar zbatimi i rekomandimeve të pa zbatuara në auditimin, përpara tij. Për arsye se Kontrolli i Lartë i Shtetit është shprehur në auditimin e mëparshëm për statusin e këtyre rekomandimeve, trajtimi i ecursisë së tyre nga subjekti, në këtë auditim është pjesë e këtij materiali, por jo pjesë e tabelës së zbatimit të rekomandimeve, për të mos krijuar mbivendosje.

B. Masa organizative.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2023-2025, u konstatua se: Nuk janë marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;

Për PBA 2023-2025 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Pukë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2023-2025 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga përgjegjësit e sektorëve të Bashkisë Pukë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

Tavanet përgatitore dhe përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve.

Gjithashtu konstatohet se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23; Pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të kryhen konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se:

Është ngritur grupi menaxhimit strategjik me urdhër nr 14 datë 13.03.2024.

-Janë kryer fazat e e miratimit te PBA, janë respektuar fazat sipas udhëzimit, është dërguar dokumenti në Ministrinë e Financës me shkresën nr. 1046/2 prot., datë 30.05.2024. Me shkresën nr. 8592 prot datë 19.06.2024 janë dërguar mendimet nga Ministria e Financave. Është miratuar në keshill me vendim nr.30 datë 10.07.2024, tavanet e PBA 2025-2027 dhe konfirmuar nga prefektura me shkresën nr.498/1 prot., datë 19.07.2024. Është bërë njoftimi me shkrsen nr.1852 prot., datë 04.10.2024 për konsultim me publikun sipas grafikut. Është miratuar faza përfundimtare së bashku me buxhetin.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1 I zbatuar

1.2.Rekomandimi: Nënpunësi autorizues dhe nënpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raporte 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen dhe në Ministrinë e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Janë hartuar raportet e monitorimit, sipas formateve të udhëzimit 4/8/12 mujore. Katër mujori është dërguar me email ministrisë së financave, është miratuar 8/ mujori me vendim keshilli nr.43 datë 16.10.2024, konfirmim prefekturë nr. 726/1 prot., datë 01.11.2024 dhe 12 mujori me vendim keshilli nr.10 datë 18.04.2025, konfirmim prefekturë me shkresë nr. 302/1 prot., datë 05.05.2025

Zbatimi: Rekomandimi 1.2 I zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e buxhetit të vitit 2023, rezulton se është realizuar në masën 81%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 590,055 mijë lekë është realizuar vlera 479,834 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Zëri kryesorë i shpenzimeve, investimet është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 154,586 mijë lekë është realizuar në masën 108,671 mijë lekë ose 70%, që do të thotë se nga Bashkia Pukë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Në lidhje me faturat e palikujduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë në vlerën 30,633,989 lekë, nga e cila me të ardhurat e veta 29,479,147 lekë dhe me fondet nga Ministritë e linjës për vlerën 1,154,842 lekë. Në raport me totalin e shpenzimeve të vitit 479,834 mijë lekë, kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare, pasi zë 8% të totalit.

Këto veprime janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se:

Është bërë plani i shlyerjes së detyrimeve referuar stokut deri më 31.12.2023. Planifikimi në vite i detyrimeve është pasqyruara dhe bërë pjesë e PBA-së 2024-2026.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 I zbatuar

2.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Mbi bazën e dokumentave të vëna në dispozicion, nuk pasqyrohet ecuri në këtë drejtim.

Zbatimi: Rekomandimi 2.2 I Pazbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK (nga shitja e pasurisë), Drejtoria e Transportit (për mjetet qarkullues), Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër (tatim fitim thjeshtuar) dhe Ujësjiellës Kanalizime Sha Pukë (abonentët familjarë), Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave (renta minerare), Bashkia Pukë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në qoftë se krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Pukë nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Këto veprime

janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pukë.

3.1.Rekomandim: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Sektori Tatim – Taksave, është krijuar baza të dhënave për subjektet persona fizik, juridik, familjarë e të tjerë. Për zgjerimin e kësaj baze janë drejtuar me shkresën nr.1831 prot., datë 01.10.2024 “kërkesë për marrje të dhënash”, si dhe shkresën nr.1814 prot, datë 30.09.2024 “kërkesë për marrje të dhënash lidhur me numërin e familjeve rezidente në juridiksionin e Bashkisë Pukë, me qëllim planifikimin e të ardhurave vendore për tu arkëtuar vitet në vazhdim”.

Zbatimi: Rekomandimi.3.1 I Zbatuar

3.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjatësitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.3.2 I Pazbatuar

4.Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Pukë kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim Taksave nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Pukë i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Taksave.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendore”. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në

përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Tatim Taksave të merren masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të taksave dhe tatimpaguesve vendore në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, me qëllimin ruajtjen dhe mirë administrimin e të dhënave.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Sektori Tatim-Taksave janë hartuar/krijuar regjistrat e taksave e tarifave për bizneset. Institucionet dhe abonentet familjarë dhe po vijohet me perditësimet e tyre.

Zbatimi: Rekomandimi. 4.1. I Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,725,698 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Nga auditimi u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit, në shumën **-30,633,989 lekë**. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilancin kontabël është pasqyruar në mënyrë jo të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar. Vlera e cila duhej paraqitur është 54,359,687 lekë, e cila duhej të përfaqësonte llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, e cila duhej të përbëhej sipas tabelës së mëposhtme:

Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”

000/Lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	14,655,544
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	20,681,611
Paga personeli llogaria 42	13,826,786
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431	669,936
Sigurime shoqërore llogaria 435	3,982,435
Sigurime shëndetësore 436	543,375
Totali	54,359,687

Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 32, kreu III “Procedurat për Përgatitjen, Paraqitjen dhe Konsolidimin e Pasqyrave Financiare në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Në mbyllje të bilancit kontabël të vitit 2024, në llogarinë 4342, në kredi janë pasqyruar llogaria 401-408, detyrime për detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra për llogaritë 421,435,431,436,427,467 për vendime gjyqësore, të barabartë me llogarinë 7206 në formatin nr. 2 të pasqyrës së pozicionit financiar.

Zbatimi: Rekomandimi. 5.1. I Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën

historike 633,837,427 lekë, është përfshirë vlera prej **85,000,000 lekë** me emërtimin e objektit “Ujësjiellësi i Gjeganit” e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, pasi kjo vlerë është kapitalizuar dhe përlllogaritur dhe normë amortizimi pa u kryer punimet përfundimtare dhe pa u marrë në dorëzim si investim. Vlera prej 85,000,000 lekë duhej të paraqitej në shpenzime në proces për sa kohë investimi nuk ka përfunduar dhe marrë në dorëzim. Po ashtu është mbajtur jashtë kontabiliteti objekti Ujësjiellësi i fshatit Luf- Bashkia Pukë me vlerë 96,256,588 lekë i cili është marrë në dorëzim përfundimtar nga bashkia Pukë me datë 13.11.2023. Është çliruar dhe garancia e punimeve për këtë objekt, çka do të thotë se objekti duhej kapitalizuar në asetet e bashkisë dhe duhej përlllogaritur dhe norma e amortizimit nëse aplikohet. Kjo vlerë ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datën 31.12.2023, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar për vitin 2023 në vlerën 29,374,757 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2022, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

6.1 Rekomandimi: Nëpunësi zbatues në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, të marrë masa për kapitalizimin e të gjitha objekteve të marra në dorëzim. Po ashtu të sistemojë vlerat e paraqitura gabim në pasqyrën 7/b me qëllim paraqitjen reale të gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata. **Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024, me daljen *ekstra* datë 03.01.2024 shuma 79,761,253 është kaluar nga AQT në AQT në proces dhe është reflektuar dhe sistemimi në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata.

Zbatimi: Rekomandimi. 6.1. I Zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 244,905,059 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, në fund të vitit 2023 ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likujtime për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Vlera në total prej 73,804,717 lekë duhej kapitalizuar dhe jo të kategorizohej si shpenzim në proces. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. Për sa më sipër konstatohet se për këtë llogari nuk ka një pasqyrim real jo vetëm të gjendjes faktike por për pasojë ka ndikuar në vlerën e fondit bazë neto të institucionit, dhe në pasqyrimin e aseteve në dispozicion të kësaj bashkie

7.1 Rekomandimi: Drejtori i financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 të sistemojë me analizë llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerave në kontabilitet. Po ashtu të kapitalizojë vlerën 73,804,717 lekë e cila i përket investimeve të përfunduara prej vitesh.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Drejtoria e Menaxhimit Financiar me shkresën nr.1795 prot., datë 26.09.2024 i është drejtuar sektorit juridik për të gjetur rrugën ligjore lidhur me njoftimin e subjekteve për plotësim dokumentacioni. Janë njoftuar shkresërisht subjektet: “A. G.”shpk me shkresën nr. 1992 prot., datë 28.10.2024 për dorëzim dokumentacioni me qëllim mbylljen e fazës përfundimtare akt-marrje në dorëzim të automjeteve dhe dokumentacion për çlirim garancie mbas mbarimit të afateve përkatëse. Subjektit “Sh” shpk i është drejtuar me shkresë nr.1993 prot., datë 28.10.2024, subjektit “D.” shpk drejtuar me shkresë nr.1994 prot., datë 28.10.2024 dhe subjektit “A.I” G.K. me shkresë nr.1991 prot., datë 28.10.2024 me objekt; kërkesë për dorëzim dokumentacioni, akt-marrje në dorëzim, proces verbalin e kolaudit të objektit dhe akt-marrje në dorëzim përfundimtar të objektit, me qëllim kapitalizimin e objekteve sipas kërkesave ligjore. Jemi në fazë konsultimi me zyrën juridike për hapat e mëtejshëm.

Zbatimi: Rekomandimi. 7.1. Në Proces

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 25,959,120 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 4,703,164 lekë dhe pakësime në vlerën 2,694,800 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 20,681,611 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” ka mospërputhje e cila duhej të ishte 27,967,484 lekë dhe jo 20,681,611 lekë. Sa më sipër është kjo llogari është nënvlerësuar në shumën 7,285,873 lekë. Ky veprim ka sjellë një deformim të informacionit kontabël dhe nuk paraqet gjendjen reale të kësaj llogarie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Me qëllim identifikimin dhe raportimin e saktë e detyrimeve të prapambetura, Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për të bërë sistemimet e nevojshme për këtë llogari, me qëllim paraqitjen e saktë e informacionit kontabël.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Drejtoria e Menaxhimit Financiar ka paraqitur listën analitike të rakorduar me thesarin për llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila është pjesë përbërëse e Bilancit kontabël të vitit 2024.

Zbatimi: Rekomandimi. 8.1. I Zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se: Nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit sipas pikës 74 të UMF nr.30 ku përcaktohet se: Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, **bëhen hyrje** në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gruposur ose djegur. Sipas pikës 109 të UMF. Nr. 30 datë 27.12.2011. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë, Drejtoria e Financës të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet gjurma e auditit dhe të kryhet ndarja e aktiveve nga ato pa vlerë, si dhe të plotësohet i saktë i dokumentacioni justifikues.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Gjatë vitit 2024 nuk ka nxjerrje jashtë përdorimi, referur procesit të inventarizimit dhe pasqyrave financiare.

Zbatimi: Rekomandimi. 9.1. **I Zbatuar**

10.Gjetje nga auditimi. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Pukë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Në territorin e Bashkisë Pukë, janë miratuar listat përfundimtare të pronave vetëm për bashkinë dhe ish-komunën Qelëz. Tre ish-komunat, Gjegjan, Rrapë dhe Qerret nuk kanë listë përfundimtare të pasurive të paluajtshme të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Pukë nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i pa përditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në strukturën e bashkisë dhe rregulloren e brendshme nuk përcaktohet asnjë sektor apo specialist për ushtrimin e funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për ushtrimin e funksioneve në lidhje me përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme, duke krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Me vendim nr.30 dhe nr.,2533 prot., datë 22.12.2023, mbi miratimin e organigramës dhe strukturës së bashkisë Pukë, njësi administrative, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2024, është miratuar sektori i aseteve publike për 3 pozicione, të cilat aktualisht nuk janë të plotësuara si mungesë burimesh njerëzore. Po ashtu vlen të theksohet se ndonëse sektori i aseteve publike ekziston, nuk ka detyra të përcaktuara për ushtrimin e funksioneve.

Zbatimi: Rekomandimi. 10.1. **Zbatuar pjesërisht**

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aseteve rezulton se, nga 195 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Pukë dhe ish-Komunës Qelëz (aktualisht njësi administrative), vetëm 10 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Nga evidencat e shqyrtuara në lidhje me certifikata e pronësisë, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të saktë mbi numrin real të regjistrimeve të pronave. Në lidhje me pasurinë nr. 47/4, zona kadastrale 3092 me sipërfaqe 800 m² truall dhe 800 m² ndërtesë, objekti gjimnazi, ish-Komuna Qelëz, rezulton se në certifikatën e pronësisë mungon sipërfaqja e truallit funksional. Kjo pasuri i përkon numrit rendor 621 të inventarit me sipërfaqe 1800 m² truall dhe 800 m² ndërtesë. Si pasojë, rezulton një sipërfaqe 1000 m² më pak sesa inventari, për të cilën në Bashkinë Pukë nuk administrohet asnjë informacion nga Zyra Vendore e ASHK Pukë për arsyt e kësaj difference.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë masa për të krijuar regjistrin e çertifikatave të pronësisë si dhe të kërkojë informacion mbi statusin juridik të truallit funksional të gjimnazit me nr. 47/4 pasurie, për diferencën prej 1000 m² që rezulton mes çertifikatës dhe inventarit, për të cilën të kërkojë regjistrimin e kësaj sipërfaqeje.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nuk ka informacion të dokumentuar lidhur me rekomandimin e mësipërm.

Zbatimi: Rekomandimi. 11.1. I **Pazbatuar**

12.Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë ka në administrim një fond pyjor dhe kulloror prej 45774.843 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, ndryshuar me VKM nr.134 datë 3.3.2021. Në lidhje me regjistrimin e sipërfaqeve të fondit pyjor/kulloror në Bashkinë Pukë rezulton se:

- Për pasurinë me nr.748/4, me sipërfaqe 19954 m² pyll, konstatohet se është përfituar me ndarje sipas shënimit në kartelë por nuk ka të dhëna për pasurinë “mëmë”. Certifikata e pasurisë është lëshuar me datë 16.03.2023.
- Për totalin 660.14 ha, të regjistruar në emër të ish-Komunës Qerret me datë lëshimi certifikatë 21.09.2010 kanë probleme me hartën treguese, duke mos individualizuar në planvendosje kufijtë realë të këtyre sipërfaqeve.

Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Pukë nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 50-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore. Në lidhje me sipërfaqet e regjistruara, të marrë masa për të aplikuar për certifikata të reja pronësie për pasuritë e regjistruara në emër të ish-komunës Qerret si dhe të kërkojë informacion për pasurinë me nr. 784/4 në lidhje me pasurinë e origjinës dhe ndarjet që ka pësuar, me qëllim identifikimin e saktë të totalit të sipërfaqes së rezultuar për pasurinë përkatëse.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nuk ka informacion të dokumentuar lidhur me rekomandimin e mësipërm.

Zbatimi: Rekomandimi. 12.1. I **Pazbatuar**

13.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me kontratat e qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kulloror rezultoi se:

Në 3 raste për subjektet “N.E.” sh.p.k, “L.E.” sh.p.k, “V.” sh.p.k konstatohet se në lidhje me pagesën e detyrimit, në nenin 5 është përcaktuar se pagesa e qirasë do të bëhet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të punimeve, e cila është edhe dita e hyrjes në fuqi të kontratës. Ky parashikim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik”, Si pasojë, këto kontrata nuk prodhojnë efekte financiare për Bashkinë Pukë. Në lidhje me kohëzgjatjen është konstatuar se afatet e vendosura nuk i përshtaten qëllimit të objektit të kontratës si dhe dosjet përkatëse nuk janë të inventarizuara me dokumentacionin detyrues si planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit për përcaktimin e sipërfaqeve të linjave të shtrirjes, etj. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 24 të Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat,

procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Në 1 rast, për kontratën nr.1498/1 datë 28.08.2023 (aneks kontratë) për HEC “F.” për shoqërinë “M.G.” sh.p.k, vlera e qirasë nuk është përlllogaritur plotësisht sipas VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. Konkretisht, vlera për trungishte për sipërfaqen 13.425 ha është përlllogarit gabim, duhet të ishte në vlerën 322,400 lekë me vlerë tarife 240,000 lekë jo 120,000 lekë, e si rrjedhojë rezultojnë një diferencë prej 161,200 lekë. Po ashtu, mungon përlllogaritja e tarifave për rrugën e kalimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 53-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë masa për të anuluar kontratat e qirave për dhënie në përdorim të fondit pyjor për subjektet “N.E.” shpk, “L.E.” shpk, “V.” sh.p.k si kontrata të lidhura në kundërshtim me kuadrin rregullator, duke njoftuar për këtë qëllim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Po ashtu, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve duke i plotësuar me dokumentacionin si planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit etj. Për kontratën me subjektin “M.G.” të bëjë një rivlerësim të tarifave, përfshirë rrugën e kalimit.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezultojnë se: Nuk ka ecuri dhe informacion të dokumentuar lidhur me rekomandimin e mësipërm.

Zbatimi: Rekomandimi. 131.1. I Pazbatuar

14.Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 707 datë 21.05.2024 është administruar në KLSH ankesa e znj. V.K. e cila shpreh problematikën se i është ulur niveli i pagës së pozicionit. Konkretisht, me urdhrin nr. 337 datë 29.08.2023, znj. V.K. është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Konviktit “Ali Bytyçi”, me datë fillimi të marrëdhënieve financiar 01.09.2023 me pagë të përlllogaritur (pagë grupi 11,000 + pozicioni 68,500 + 2 % vjetërsi), sipas pikës 2 të këtij urdhri. Për muajin shtator, znj. V.K. është paguar sipas përlllogaritjes të urdhrin të emërimit, ndërsa në muajin tetor e në vijim është paguar sipas përlllogaritjes (pagë grupi 12,000 lekë + pozicioni 48,000 lekë + 2% vjetërsi). Nga auditimi rezultoi se:

- Znj. V.K., që ushtron detyrën e Drejtor Konvikti, ka marrë për 1 muaj (shtator 2023) pagën e zv/drejtorit të shkollës së mesme deri në 300 nxënës (që emërohet nga drejtoritë arsimore por jo Bashkia dhe s’bën pjesë te funksionet e deleguara) dhe nga tetori 2023 e në vijim është paguar me pagën e kujdestares së konviktit.
- Ndryshimi i pagës së pozicionit nga 68,500 lekë (paga e pozicionit zv/drejtor i shkollës së mesme deri në 300 nxënës) në 48,000 lekë (paga e pozicionit të edukatore/kujdestare, grupi 2), është kryer në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” i ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.4.2023.
- Zbritja e pagës nuk ka ndjekur asnjë procedurë administrative si dhe nuk është njoftuar zyrtarisht punonjësja znj. V.K. për ndryshimin e bërë, me qëllim njohjen me arsyet e këtij ndryshimi dhe ushtrimin e të drejtës ligjore të ankimit.
- Nga ana e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Pukë janë miratuar dhe kryer veprimet financiare për ndryshimin e pagës, nga 68,500 lekë në 48,000 lekë, pa administruar dokumentacionin përkatës, konkretisht urdhrin e ndryshuar të emërimit. Si pasojë, nuk ka gjurmë auditimi mbi rrjedhën e

dokumentuar të transaksioneve financiare, në rastin konkret për uljen e pagës, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjithë veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Në zbatim të VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, lidhja nr.3, për pozicionin “Drejtor Konvikti” përllogaritja duhet të ishte (grupi 14,000 + pozicioni 80,000 + 2 % vjetërsi). Nga përllogaritja rezulton se znj. V.K. ka marrë pagë neto (tetor 2023 e në vazhdim) në vlerën 52,436 lekë ndërkohë që duhet të merrte një pagë neto në vlerën 80,246 lekë, me një diferencë prej 27,810 lekë. Për muajin shtator, kur është paguar me pozicionin e zv/drejtorit të shkollës së mesme deri në 300 nxënës me pagë neto 68,449 lekë, rezulton një diferencë prej 11,797 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 69-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa për ndryshimin e urdhrin nr.337 datë 29.08.2023 për emërimin e znj. V.K. në pozicionin e Drejtorit të Konviktit “Ali Bytyçi”, duke përcaktuar përllogaritjen e pagës si vijon (pagë grupi 14,000 lekë + pozicioni 80,000 lekë + 2% vjetërsi), në bazë të VKM nr. 175/2017 i ndryshuar si dhe t’i kthehen diferencat e mbajtura padrejtësisht nga paga, duke filluar nga muaji shtator 2023 e në vijim.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Me urdhërin nr. 335, me nr. 1615 datë 03.09.2024 “Për ndryshim dhe kompensim page” për zj.V.K. është urdhëruar Drejtoria e burimeve njerëzore dhe drejtoria e menaxhimit financiar për kompesimin dhe zbatimin e rekomandimit të lënë në Raportin Përfundimtar të KLSH-së në bazë të Urdhërit nr. 200, të Bashkisë Pukë datë 21.08.2024 “Për zbatimin e Rekomandimeve dhe Detyrave të lëna nga KLSH.

Zbatimi: Rekomandimi. 14.1. I Zbatuar

15.Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr.1085 datë 12.12.2023 është administruar ankesa e z. A.G. i cili shprehet se Bashkia Pukë nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për dhënien e shpërblimit të pagës për daljen në pension.

Me shkresën nr. 1987/2 datë 09.05.2024, kthim përgjigje KLSH-së është refuzuar dhënia e pagesës së shpërblimit me arsyetimin se “shtetasi A.G., i datëlindjes 04.02.1957 ka arritur moshën e daljes në pension me datë 04.02.2022. Zgjatja e mëtejshme e marrëdhënieve të punës deri me datë 19.06.2023, pra 16 muaj më shumë nga afati është bërë në kundërshtim me ligjin pasi nuk ndjekur asnjë procedurë për shtyrjen e daljes në pension”.

Sa më sipër, konstatohet se kjo shkresë nuk ka referencë në asnjë bazë ligjore dhe është në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, pika 7 “Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet:- daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 69-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa për dhënien e shpërblimit të një page mujore, me rastin e daljes në pension për z. A.G..

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Me urdhërin nr. 337, shkresë nr.1615 prot., datë 03.09.2024 “Për dhënie page mujore” z.A.G., është kryer veprimi i dhënies së shpërblimit me rastin e daljes në pension sipas kërkesave ligjore. Është kryer zbatimi i rekomandimit të lënë në Raportin Përfundimtar të KLSH-së (faqe 69-73) dhe sipas pikës 15.1 të Urdhërit nr. 200, të Bashkisë Pukë, datë 21.08.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga KLSH.

Zbatimi: Rekomandimi. 15.1. I Zbatuar

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 867/7 prot., datë 01.02.2024, rezulton se:

Nga Bashkia Pukë me shkresën nr. 1895/18 prot., datë 22.02.2024 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujor, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekti, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a. Nga 23 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat 3 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht 9 masa nuk janë zbatuar dhe 10 masa janë në proces zbatimi.

b. Nga 3 masa për përdorimin e fondeve me efektivitet në vlerën **1,655,604 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është e pazbatuar.

c. Nga 6 masa për të ardhura të munguara në vlerën **33,174,957 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 3 masa janë në proces zbatimi dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar.**

d. Nga 3 masa disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht, rezultojnë 3 masa në proces zbatimi.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

16.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, rikërkujmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

(Masat e rikërkujmë në auditimin e mëparshëm dhe zbatimi i tyre nga subjekti)

A. Masa organizative:

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë dhe menaxherët kryesorë nuk janë marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa që për 12 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përllogariten penalitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi).

4.2.Rekomandim: Për çdo vit buxhetor të kryhen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Pukë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi).

5.1.Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

10.1.Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Zyrën e Tatim Taksave, Bashkia Pukë të marrë masa për evidentimin dhe kontabilizim të detyrimeve për taksat/tarifa vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë në llog 468 “Debitorë të ndryshëm”, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tyre.

10.2.Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, të bashkëpunojë dhe koordinojë punën më Zyrën e Tatim Taksave dhe me Zyrën e Gjendjes Civile dhe të marrin të dhëna nga Ujësjetllës Kanalizime Sh.A, Pukë apo dega e Operatorit të Shpërndarjes Elektrike (OSHE) Pukë, për të nxjerrë numrin e saktë të familjeve që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Pukë dhe në bazë të tyre të planifikojnë të ardhurat që do të arkëtojnë për vitet në vazhdim.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave janë marrë veprimet ligjore për evidentimin dhe kontabilizimin e tyre dhe konkretisht si më poshtë vijon :

1.Urdheri nr.589 prot, datë 04.11.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e taksapaguesve familjarë dhe biznese që kryejnë aktivitet brenda juridiksionit Pukë”.

2.Shkresës nr.1816 prot, datë 30.09.2024 “Kërkesë lidhur me zbatimin e Rekomandimeve të KLSH, si dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e të ardhurave të munguara përfshirë debitorët”.

3.Shkresës nr.1445 prot, datë 07.08.2023 dhe nr.2361 prot, datë 06.12.2023

Nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave janë marrë veprimet ligjore për evidentimin dhe kontabilizimin e tyre.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Zbatuar

12.1.Rekomandim: Bashkia Pukë, në buxhetin e vitit 2024, të planifikojë fonde nga të ardhurat e veta apo ti kërkojë mbështetje buxhetore pushtetit qendror për investimin dhe realizimin e këtyre projekteve. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

15.1.Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve

Publike në Bashkinë Pukë për regjistrimin e objekteve të pa regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

19.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithëm të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës debitore 311,550 lekë, gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimit të mësipërm. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

B. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet.

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës për të analizuar dhe verifikuar vlerësimin e rezultateve të kësaj analize si dhe të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për punonjësit përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe për vështirësinë financiare që i është shkaktuar Bashkisë Pukë në vlerë 1,655,604 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

C. Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

2.1.Rekomandim: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillim Territorit, të marrë masa që të për të gjithë personat/subjektet të cilët janë pajisur me leje legalizimi, të aplikohet vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe në raste të mos arkëtimit të ndiqen të gjitha procedurat ligjore përkatëse.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

3.1.Rekomandim: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 107,000 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

6.1.Rekomandim: Bashkia Pukë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie si dhe të krijohet një regjistër i taksës për tokën bujqësore ku të evidentohen të gjithë personat me të dhëna të sakta.

Nga ana e Sektorit të Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, gjatë planifikimit të të ardhurave nga toka bujqësore të merren masa për saktësimin e sipërfaqes në vlerën 762 Ha, e llogaritur më pak në vitet e kaluara, ku me çmimin minimal sipas Paketës Fiskale korrespondon në vlerën 381,000 lekë, si e ardhur e munguar në Buxhetin e Bashkisë Pukë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi.. I Pazbatuar (Rikërkohet Zbatimi)

Menjëherë

Konkluzioni për masat e rikërkua në auditimin e mëparshëm:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 867/7 prot., datë 01.02.2024, rezulton se:

Nga Bashkia Pukë me shkresën nr. 1895/18 prot., datë 22.02.2024 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e aftit 6 mujor, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekti, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a. Nga 23 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat 3 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht 9 masa nuk janë zbatuar dhe 10 masa janë në proces zbatimi.

b. Nga 3 masa për përdorimin e fondeve me efektivitet në vlerën 1,655,604 lekë të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është e pazbatuar.

c. Nga 6 masa për të ardhura të munguara në vlerën 33,174,957 lekë të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 3 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar.

d. Nga 3 masa disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht, rezultojnë 3 masa në proces zbatimi.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Pukë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën **277,091 lekë**, për 1 rast, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Pukë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e

largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë nuk ka dokumentacion për ecurinë e këtij procesi.

Zbatimi: Rekomandimi, 1.1. **I Pazbatuar**

D. Masa për eliminimin e efekteve negative né menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e TNI nga ndërtimet informale, rezulton se:

Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor Bashkia Pukë, deri në fund të vitit 2023 janë legalizuar gjithsej 19 subjekte për vlerën 1,566,676 lekë, nga e cila likuiduar vlera 140,651 lekë, duke mbetur për detyrim vlera 1,426,025 lekë, e cila konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhet, pasi nuk rezulton e kontabilizuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.6, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatim Taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **1,426,025 lekë.**

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga Bashkia Pukë janë marrë masa për ecurinë e këtij procesi si vijon; Drejtoria e menaxhimit financiar dhe sektori i tatim-taksave kanë kryer njoftimet për likuidimin e detyrimeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë për debitorët sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Emër	Mbiemri	Nr.prot/ njoftimit	data e	Lloji i objektit banim/soci al ekonomike	Sip. totale e ndërtimit (m ²)	% që aplikohet	Shuma që duhet të arkëtohet (lekë)	Faturuar		Paguar 2023	Debia 31.12.2023
									Po	Jo		
1	B. Sha		Proces Gjyqësor									1,138,425
2	R	S	1270/9	26.08.2024	Banim	337.3	0.5%	55,436	Po			55,436
3	M	M	1270	26.08.2024	Banim	321.6	0.5%	52,855	Po			52,855
4	R	M	1270/1	26.08.2024	Banim	83.03	0.5%	13,690	Po			13,690
5	N	H	1270/2	26.08.2024	Banim	59.3	0.5%	9,746	Po			9,746
6	GJ	F	1270/3	26.08.2024	Banim	158.2	0.5%	26,000	Po			26,000
7	M	F	1270/4	26.08.2024	Banim	121.7	0.5%	20,001	Po			20,001
8	N	M	1270/7	26.08.2024	Banim	106.7	0.5%	17,536	Po			17,536
9	GJ	C	1270/5	26.08.2024	Banim	60.5	0.5%	9,943	Po			9,943
10	K	N	1270/6	26.08.2024	Banim	272.9	0.5%	44,851	Po			44,851
11	L	N	1270/8	26.08.2024	Banim	77.4	0.5%	12,721	Po			12,721

Deri në këtë fazë janë dërguar 11 njoftime për likuidim nga 20 debitorë të konstatuar pasi të dhënat e aplikuesve vijnë nga ASHK Shkodër. Për sa më sipër grupi i auditimit vlerëson se ky rekomandim konsiderohet në proces.

Zbatimi: Rekomandimi. 1.1 **Në Proces**

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e taksës së tokës bujqësore, rezultojnë se kjo taksë për vitin 2023 është realizuar në vlerën 122 mijë lekë nga vlera 124 mijë lekë të planifikuara ose në masën 98 %. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Pukë rezultojnë se vlera debitorë për taksën e tokës bujqësore, deri në fillim të vitit 2023 është 2,746,417 lekë, përse i përket debitorëve të cilët janë krijuar gjatë vitit 2023 rezultojnë se nuk janë krijuar debitorë të rinj, **si rrjedhojë detyrimi deri më 31.12.2023 rezultojnë në vlerën 2,746,417 lekë** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë, pasi është e pakontabilizuar.

Theksojmë se, sipërfaqe e tokës bujqësore e taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore.

Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermerë që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitorë në vlera të konsiderueshme debitorë. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrën për tokat në disponim dhe përdorim.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24. ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. VKB nr. 56 prot., datë 30.12.2022 pika Tab 2, Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.6, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Sektori i Tatimit Taksave, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistratit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit. Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës **2,746,417 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezultojnë se: Sektori Tatimit Taksave në bashkëpunim me Njësitë Administrative, si dhe informacionit të marrë nga Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokave Qarku Shkoder (DAMT), ka hartuar regjistrat paraprak për çdo fshat të njësisë administrative. Gjithashtu, Sektori Tatimit Taksave në bashkëpunim me Njësitë Administrative është në proces e sipër të punës për përditësimin e regjistrave tokës bujqësore. Sektori Tatimit Taksave, ka nxjerrë shkresën nr.297 prot, datë **08.02.2024** “**kërkesë për nxjerrjen e dërgimin e njoftim vlerësimeve tatimore përsonave fizik, juridik, abonentë familjarë e të tjerë** .

Zbatimi: Rekomandimi. 2.1 Në Proces

3.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Pukë lidhur me gjendjen e debitorëve progresive për subjektet fizik/juridik, konkretisht biznesi i madh, biznesi i vogël dhe ambulant në fund të vitit 2022 rezultojnë në një numër debitorësh, prej **93 subjekte në vlerën 13,232,744 lekë**. Detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezultojnë për 17 subjekte në vlerën 973,727 lekë,

duke rezultuar në fund të vitit 2023 (progresive), prej 110 subjektsh me vlerë debitorë prej **14,206,471 lekë**.

Nga auditimi deri në fillim të vitit 2023 gjendja e debitorëve nga abonentët familjarë është në vlerën 557,194 lekë për 1.857 familje. Janë krijuar brenda viti 2023 në vlerën 244,954 lekë për 870 familje, duke mbetur debitorë progresiv deri më 31.12.2023 në një numër prej **2.655 familje debitorë në vlerën 802,148 lekë**.

Në fund të vitit 2023 borxhi tatimor në Bashkinë Pukë është në vlerën **19,206,568 lekë** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pukë.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të fushës ndaj debitorëve të Bashkisë Pukë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94

3.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Pukë, si, Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor, Sektori Juridik, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **19,206,568 lekë** kjo për subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Nga sektori Tatim taksave po vijohet me ndjekjen e rugëve ligjore për arkëtimin e debitorëve përmes masave shtrënguese, konkretisht edhe konkretisht U. Bllokimi nr 299 prot, datë 08.02.2024, për vlerën **2,779,201 lekë**, si dhe të tjerë subjekte të cilët vijnë proceset gjyqësore si “ Beralb ” sh.a, për vlerën **2,445,709 lek** (shkresa nr.1923 prot, datë 14.10.2024) . **Po vijohet me ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me arkëtimin e debitorëve.**

Zbatimi: Rekomandimi. 3.1 Në Proces

4.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me likuidimin e kontratave të qirave konstatohet se në vitin 2023 janë aktive 8 kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor, nga të cilat 4 subjekte kanë për objekt vendosjen e antenave, 1 subjekt ka për objekt sipërfaqe kullorë dhe 3 subjekte kanë si objekt “HEC”.

Debia progresive e akumuluar ndër vite, në vitin 2023 rezulton se është në vlerën 6,420,200 lekë, të cilat nuk janë kontabilizuar. Për vitin 2023, rezulton debitor një subjekt “E.U.” shpk, i cili nga detyrimi prej 1,735,400 lekë ka paguar vlerën prej 1,400,000 lekë ose 335,400 lekë më pak se detyrimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 20 ku përcaktohet se “Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse”; Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të nenit 10, pika 10.1, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 53-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë të gjitha masat ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës së debisë progresive nga 8 kontrata, në masën **6,240,200 lekë**.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Bashkia Pukë me shkresë nr. 1445 prot., datë 07.08.2023 dhe shkresë nr. 2381 prot., datë 08.12.2023 ka kërkuar nga të gjitha

njësitë administrative për nxjerrjen e debitorëve. Nga sektori Tatim Taksave janë nxjerë njoftim detyrimet kontraktore për secilin subjekt kontraktues të qerasë për “fond pyjor e kullosor”, dhe po vijohet në bashkëpunimi me sektorët tjerë me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me arkëtimin e vlerave debitore.

Zbatimi: Rekomandimi. 4.1 Në Proces

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se në fund të vitit 2022 janë gjithsej 16 gjoba në vlerën 90,000 lekë, si dhe përgjatë vitit 2023 janë krijuar 12 gjoba në vlerën 12,000 lekë, dhe në mënyrë progresive deri në 31.12.2023 janë krijuar 28 gjoba në vlerën 102,000 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat shtrënguese si dhe nuk janë aplikuar kamat vonesa sipas ligjit në fuqi. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 102,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë urdhër nr.138 datë 28.05.2025 dhe nr 914 prot., me objekt: “ Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative” , në zbatim të VKM nr.274 datë 09.05.2025, nenit 10 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr.127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga 1 Janar 2015 deri më datë 30 nëntor 2024, ka vendosur fshirjen e këtyre masave administrative. Nisur sa më sipër, grupi i auditimit e vlerëson të ezauruar rekomandimin.

Zbatimi: Rekomandimi. 5.1 I Zbatuar

E. Masa Disiplinore.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pukë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. “Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 4 punonjës:

1. Znj. F.L., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe Nëpunës Zbatues, për problematikën e konstatuar në hartimin e pasqyrave financiare, zbatimin e buxhetit dhe trajtimin e ankesave, këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 12-34, etj. (Trajtuar

më hollësisht në pikën III.2.1, faqe 12-35, III.3.2.2 faqe 34-53 dhe pikën III.2.5 faqe 69-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Z. N.A., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, këto veprime janë në kundërshtim me nenin 93, 94, 95, 131 të parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.2.6, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Z. S.GJ, me detyrë Drejtor Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arsimit dhe Rinisë, për parregullsitë e konstatuara në trajtimin e ankesave. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.5, faqe 69-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Z. A.H., me detyrë Drejtor për pyjet dhe kullotat, aktualisht me detyrë inspektor pyjesh, për problematikat e konstatuara në administrimin e asetëve dhe pyjeve. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.3, faqe 53-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezulton se: Me urdhërin nr. 437, datë 07.11.2024 “Për zbritje në detyrë” z. N.A., nga përgjegjës i sektorit të taksave, tarifave dhe borxhit tatimor në specialist i taksave, tarifave dhe borxhit tatimor. Është kryer pjesërisht zbatimi i rekomandimit të lënë në Raportin Përfundimtar të KLSH.

Zbatimi: Rekomandimi. 1. **Pjesërisht i zbatuar.**

F. Për njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Përsa më sipër për anomali të dhe mangësitë e konstatuara në zbatimin e rekomandimeve, ngarkohen me përgjegjësi z.Rr.D. me detyrë Kryetar i Bashkisë, si dhe personat përkatës sipas planit të veprimit të miratuar nga titullari.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë funksionon mbi bazën e rregullores së brendshme e cila është hartuar qysh në vitin 2015, pra 10 vite më parë, në një periudhë kur struktura organizative dhe detyrat funksionale të stafit kanë qenë të ndryshme nga ato të tanishmet. Për pasojë, ajo nuk pasqyron në mënyrë të plotë kërkesat, përgjegjësitë dhe funksionet aktuale të institucionit, çka krijon nevojën për rishikim dhe përditësim të saj. Kjo mangësi sjell paqartësi në organizim dhe përgjegjësi, mungesë të rregullave për koordinim dhe komunikim ndërmjet strukturave, dobësim të disiplinës dhe kontrollit të brendshëm, etj. Bashkia Pukë nuk ka hartuar kod të etikës për punonjësit, duke mos garantuar njohjen e detyrimeve etike që kanë punonjësit, si dhe zbatimin e etikës personale dhe profesionale prej tyre, parimet etike që duhet të ndjekin punonjësit, si: ndershmeria dhe integriteti në punë, transparenca, shmangia e konfliktit të interesit, respektimi i ligjit dhe qytetarëve, përgjegjshmëria dhe profesionalizmi, etj. Këto mangësi janë në mos përputhje me Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 9 dhe 20. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së re për organizimin dhe funksionimin e institucionit, duke përcaktuar detyrat, kompetencat, linjat e bashkëveprimit etj., të çdo strukture të njësisë vendore. Gjithashtu të hartohet kodi i etikës për punonjësit e institucionit.

Deri më 31.03.2026

2.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Pukë është hartuar regjistri i riskut vetëm nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, por jo nga strukturat e tjera, si Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike, Drejtoria e Çështjeve Juridike, Burimeve Njerëzore dhe IT, Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve, Kullotave dhe Bujqësisë, etj., së bashku me sektorët përkatës, duke mos evidentuar plotësisht risqet për realizimin e objektivave të institucionit, si dhe mos parashikimi prej tyre i masave për minimizimin e risqeve.

Gjithashtu edhe gjurma e auditimit është hartuar vetëm nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit por jo nga drejtorit dhe sektorët e tjerë të bashkisë. Lidhur me komunikimin brenda institucionit, i cili është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, u konstatua se nuk është ngritur një sistem raportimi efikas, i cili duhet të përfshinte nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e raporteve që i dorëzohen titullarit, shpeshësia e këtyre raportimeve (mujore, tre mujore etj.), në mënyrë që të vlerësohet dhe të mbikëqyret efënca dhe efektiviteti i veprimtarive të secilit sektor. Këto mangësi janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 21, neni 16, pika 2 dhe 3, neni 23. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Nga të gjitha strukturat e Bashkisë Pukë në nivel drejtorie dhe sektori, të merren masa për hartimin e regjistrit të riskut, si dhe të gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.

Deri më 31.12.2025

2.2.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë të ngrihet grup pune, i cili të përcaktoj llojet e raporteve që duhet të përgatisin drejtorët për titullarin, si dhe përgjegjësit e sektorëve për drejtorët, pikat që duhet të përmbajnë këto raporte, si dhe shpeshësinë e tyre.

Deri më 31.12.2025

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për marrjen dhe dorëzimin e detyrës, dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion nga ana e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës, fillojnë punë rishtas, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit. Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për ruajtjen e informacionit elektronik nga ana e punonjësve, gjë e cila ka të bëjë edhe me dorëzimin e këtij informacioni të eprori, apo punonjësi tjetër kur bëhen ndërprerja e marrëdhënieve të punës, apo lëvizjet brenda institucionit. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët, apo drejtoritë përkatëse të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri dhe janë në kundërshtim me: Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, pika 50, Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së burimeve njerëzore, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave të shkruara, lidhur me detyrimet që kanë punonjësit të cilët fillojnë punë rishtas, ndërpresin marrëdhëniet e punës, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit, për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal, dorëzimin e dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion.

Deri më 31.12.2025

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së inventarizimit rezulton se nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJM. Në regjistrin e aktiveve, për një pjesë të tyre vlerat janë regjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet dhe jo që nga vlerat fillestare, problematikë e mbartur që nga viti 2015 me bashkimin e ish komunave. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, pika 26, 27,30, Kreu IV, pika 74. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe nëpunësi zbatues, të marrin masa për nxjerrjen e urdhrin për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit fizik të aktiveve afatgjata, si dhe ndjekjen e procesit të inventarizimit, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme për vlerësimin e tyre real dhe paraqitjen e vlerave të plota dhe të sakta në kontabilitet.

Deri më 31.12.2025

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, u konstatua se janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka regjistër kontabël dhe informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, etj. Nuk ka informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit, për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet. Në territorin e Bashkisë Pukë, janë miratuar lista përfundimtare e pronave vetëm për bashkinë dhe ish-komunën Qelëz. Tre ish-komunat Gjogjan, Rrape dhe Qerret nuk kanë listë përfundimtare të pasurive të paluajtshme të transferuara me

Vendim të Këshillit të Ministrave. Si pasojë, në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Pukë nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezultoi i pa përditësuar. Këto parregullsi janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, Ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Pukë të marrë masa si vijon:

-Të evidentojnë dhe të kontabilizojnë në mënyrë të plotë vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie, si dhe pronat e tjera troje sipas dokumentacionit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu gjendjen reale të aseteve në pronësi të bashkisë; -Të përfshijnë në regjistrat kontabël pasuritë e llojit pyje dhe kullota që me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave (VKM), i janë kaluar në pronësi njësive vendore (ish-komunave), tashmë pjesë e bashkisë; -Të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, etj., për të siguruar verifikimin e titujve të pronësisë për të përfutur informacion të saktë mbi sipërfaqet dhe vlerat përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasiveve afatshkurtra u konstatua se llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, e cila përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të pa likuiduara, në mbyllje të vitit 2024 ka vlerën 9,341,031 lekë, e cila është 5,314,513 lekë më e ulët se në vitin 2023, ku kjo llogari ka patur vlerën 14,655,544 lekë. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie janë konstatuar 92 raste, në vlerën 8,205,842 lekë, të cilat në masën 99% i përkasin periudhës kohore 2008-2013, pra ish komunave dhe, kjo vlerë duhej të paraqitej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku paraqiten detyrimet e prapambetura. Për pasojë llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, rezultoi të jetë nënvlerësuar në shumën 8,205,842 lekë dhe deformon saktësinë e të dhënave në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo parregullsi është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III pika 3.1 nënpika 42, Aneksi 1 pika 3.3/c. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar gjatë hartimit të pasqyrave financiare, të ndajë me analiza përkatëse detyrimet afatshkurtra brenda afatit 60 ditor, nga detyrimet e prapambetura, si dhe të sistemoj vlerën 8,205,842 lekë në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, me qëllim saktësimin e kësaj llogarie, vlerë e cila është paraqitur në llogarinë 401-408 në pasqyrat financiare të vitit 2024.

Në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” gjendja e kësaj llogarisë si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 ka vlerën 0 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me gjendjet e llogarisë kundërparti 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitur në aktiv të bilancit në vlerën 51,376,834 lekë në fund të vitit 2023 dhe 48,503,919 lekë në mbyllje të vitit 2024. Pra në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, nuk pasqyron detyrimin prej 48,503,919 lekë që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë këto pasqyra. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 -Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik, seksioni “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkinë Pukë gjatë hartimit të pasqyrave financiare vjetore, të paraqesë në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin”, detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari të rakordojë me llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025

8.Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e auditit të brendshëm në nivel sektori, por kjo strukturë nuk është plotësuar me asnjë punonjës. Mungesa e shërbimit të auditit të brendshëm ndikon në përmirësimin e veprimtarisë së institucionit dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo mangësi është në kundërshtim me strukturën e miratuar, si dhe Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 10. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për sigurimin e shërbimit të auditit të brendshëm, duke plotësuar me punonjës sektorin e auditit të brendshëm, në përputhje me strukturën e miratuar, ose sigurimin e këtij shërbimi nga njëسيا e auditimit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësisve publike përkatëse, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Deri më 31.01.2026

9.Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas programit të auditimit financiar nr. prot., 618/1, datë 09.05.2024, për veprimtarinë nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023. Në përfundim të auditimit, me shkresën nr. 618/7 prot., datë 31.07.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua si vijon:

Janë dhënë 18 masa organizative, të pranuar të gjitha, prej të cilave 11 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë e zbatuar pjesërisht, 1 në proces zbatimi dhe 5 masa të pa zbatuara.

Është dhënë 1 masë për përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet në shpenzimet buxhetore, me vlerë 277,091 lekë, e cila është pranuar dhe nuk është zbatuar. Janë dhënë 5 masa që i përkasin rubrikës së të ardhurave të munguara në vlerën 29,721,210 lekë, pranuar të gjitha, prej të cilave 1 masë në vlerën 102,000 lekë është zbatuar dhe 4 janë në proces zbatimi. Është rekomanduar masë disiplinore “Vërejtje”, për 4 punonjës, pranuar nga subjekti, prej të cilave është zbatuara masa për 1 punonjës, nuk është zbatuar për 3 punonjës. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Pukë, brenda afatit 20 ditor, është hartuar Plan-Vepimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete, si dhe është bërë raportimi për këtë qëllim, por nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi ecurinë e

zbatimit te rekomandimeve, detyrë e cila duhej të zbatohet brenda 6 muajve nga marrja e rekomandimeve. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 618/7 prot., datë 31.07.2024. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju ri kërkohet** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

Masa organizative të pa zbatuara:

2.2.Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

3.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjatëmbajtjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

11.1. Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë masa për të krijuar regjistrin e certifikatave të pronësisë si dhe të kërkojë informacion mbi statusin juridik të truallit funksional të gjimnazit me nr. 47/4 pasurie, për diferencën prej 1000 m² që rezulton mes certifikatës dhe inventarit, për të cilën të kërkojë regjistrimin e kësaj sipërfaqeje.

12.1. Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore. Në lidhje me sipërfaqet e regjistruara, të marrë masa për të aplikuar për certifikata të reja pronësie për pasuritë e regjistruara në emër të ish-komunës Qerret si dhe të kërkojë informacion për pasurinë me nr. 784/4 në lidhje me pasurinë e origjinës dhe ndarjet që ka pësuar, me qëllim identifikimin e saktë të totalit të sipërfaqes së rezultuar për pasurinë përkatëse.

13.1. Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë masa për të anuluar kontratat e qirave për dhënie në përdorim të fondit pyjor për subjektet “N.E.” shpk, “L.E.” SHPK, “V.” SHPK si kontrata të lidhura në kundërshtim me kuadrin rregullator, duke njoftuar për këtë qëllim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Po ashtu, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve duke i plotësuar me dokumentacionin si plan vendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit etj. Për kontratën me subjektin “E.G.” të bëjë një rivlerësim të tarifave, përfshirë rrugën e kalimit.

Masa organizative të zbatuara pjesërisht:

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për ushtrimin e funksioneve në lidhje me përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme, duke krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

Masa për menaxhimin me ekonomicitet të shpenzimeve publike (3E)

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njëzia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2024 nga Bashkia Pukë është shpenzuar vlera 14,248,840 lekë, e cila konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomikitet dhe eficientë, me efekt negativ në buxhet.

Kjo vlerë i përket likuidimit të 2 vendimeve gjyqësore për largime të pa drejta nga puna në vlerën 290,000 lekë dhe likuidimit të 2 vendime për çështje të tjera në vlerën 13,958,840 lekë.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njëzia vendore, praktika të cilat kanë sjellë humbjen e proceseve gjyqësore, si dhe bënë të mundur evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018. “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria Juridike të analizojnë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen që kanë çuar institucionin në procese gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet lidhur me proceset gjyqësore. Vendimet e humbura gjyqësor të analizohen nga Titullari dhe të nxirren përgjegjësitë administrative, për këto vendime.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme të institucionit nga të tretët, konstatohet se taksapaguesit privat dhe familjar, në fund të vitit 2024 kanë një detyrim të pa paguar ndaj Bashkisë Pukë për taksat dhe tarifatat vendore, në vlerën 25,423,454 lekë, (vlerë debitore e pa arkëtuar). Detyrimi progresiv në fund të vitit 2024 ka një ulje prej 3,062,389 lekë krahasuar me detyrimin e vitit 2023, pasi gjatë viti 2024, nga detyrimet e prapambetura është arkëtuar vlera 5,578,329 lekë, por janë krijuar gjithashtu edhe debitorë të rinj për detyrimet e vitit 2024, në vlerën 2,515,940 lekë. Këto të dhëna tregojnë për mos marrjen e masave të plota shtrënguese në rend shterues për arkëtimin e debitorëve nga Bashkia Pukë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XI. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore në rend shterues, për arkëtimin e vlerës debitoare progresive prej 25,423,454 lekë, e cila përfaqëson detyrimin për taksat dhe tarifat vendore nga subjektet private dhe familjar, prej së cilës vlera 2,515,940 lekë i përket vitit 2024.

Deri më 31.03.2026

C. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 15, ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58, “Llojet e masave disiplinore”, VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Pukë**, që ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për punonjësit e mëposhtëm:

1.Znj. F.L., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për parregullsitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare, trajtuar më gjerësisht në pikën 2.2, faqe 19-41, për mos zbatim të UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Bashkia Pukë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

c. Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

